



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Inxhinieri
Elektrike” me profil “Energjitikë”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i
Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Dolantina Hyka

2. Dr. Fatmir Basholli

Nëntor/ 2022

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bsc në “Inxhinieri Elektrike” me profili “Energjitikë” ofruar nga Universiteti Politeknik i Tiranës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” me profil “Energjitikë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MASH Nr. 3482/1 prot datë 07.06.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër i MASH Nr. 235 Dt.24.07.2009
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 287, datë 11.08.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë i studimeve
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	53 PAE/ 12 PAK v.a. 2021-2022 53 PAE/ 12 PAK v.a. 2020-2021 53 PAE/ 11 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	70 Studentë v.a. 2021-2022 70 Studentë v.a. 2020-2021 80 Studentë v.a. 2019-2020
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë "Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë", është miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës përmes shkresës me Nr.3482/1, datë 07.06.2006; riorganizuar me urdhër MAS Nr. 235, datë 24/07/2008. Ky program studimi nuk ka kaluar më parë në proces akreditimi.

Bazuar në dokumentacionin e ofruar, në raportin e vlerësimit të brendshëm si dhe nga vizita në institucion, rezulton se programi i studimit *Bachelor* në "Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë", është program studimi i ciklit të parë, me formë studimi me kohë të plotë, zhvillohet në gjuhën shqipe, në auditor dhe i përket nivelit të 6^{te} të kualifikimit sipas kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja normale e programit të studimit është 3 vite, gjithësej 180 kredite.

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë në thelbin e tij ka si objektiv kryesor t'u japë studentëve njohuri shkencore themelore në fushën e inxhinierisë dhe më specifike në atë të Inxhinierisë Elektrike.

Programi studimit synon gjithashtu t'u japë studentëve një përgatitje me spektër më të gjerë, veçanërisht në fushën e Inxhinierisë Elektroenergjitike. Përmes kësaj synohet t'u ofrohet studentëve perspektiva më të mira lidhur me përshtatjen, fleksibilitetin dhe integrimin në tregun e punës. Gjithashtu përgatitja e ofruar i lejon studentit të diplomuar në këtë program studimi vazhdimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë Master.

Nga takimet në dekanat e departament, si edhe nga dokumentat e shqyrtuara, rezulton që ky program ka gjithashtu si qëllim të jetë në përmirësim të vazhdueshëm dhe të përafrohet me programet e studimit të ngjashme në BE dhe që përshtaten më mirë tregut dhe kërkesave të industrisë në Shqipëri.

Niveli i kualifikimit të stafit akademik që angazhohet në këtë program studimi është një garanci më shumë për vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tij.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) është ngritur nga ASCAL me Urdher nr. 59, datë 20.05.2022, mbështetur në kërkesën e Universitetit Politeknik të Tiranës, regjistruar në protokollin e ASCAL. GVJ përbëhet nga dy anëtarë: Dr. Dolantina Hyka dhe Dr. Fatmir Basholli. Koordinator teknik për ASCAL në këtë procedurë vlerësimi është MSc. Juna Mengri.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë përzgjedhur duke patur në konsideratë kompetencat profesionale në lidhje me fushën e këtij programi studimi, eksperiencën e tyre në vlerësime të programeve të studimit, integriteti profesional, mungesa e konfliktit të interesit për të siguruar paanshmëri dhe objektivitet në gjykim dhe në vlerësim.

GVJ, në punën e tij, ka shfrytëzuar "Raportin e vlerësimit të brëndshëm" të hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brëndshëm (GVB), i ngritur pranë Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, si dhe dokumentacionin në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) e përbërë nga 139 dokumenta që shoqëronin këtë raport.

Në kuadër të hartimit të raportit, grupi ka vepruar me ndarje pune, detyrash dhe përgjegjësish të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Të dhënat e vëna në dispozicion përmes DVV u diskutuan dhe u verifikuan gjatë takimeve vlerësuese të zhvilluara 21 – 23 Qershor 2022, në kujdesin e koordinatorit teknik të ASCAL. Institucioni kishte marrë të gjitha masat për realizimin me sukses të takimeve, në përputhje me agjendën e vizitës.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur dhe diskutuar gjatë takimeve me përfaqësuesit e Institucionit.

Më datë 02/11/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 186/35 Prot., datë 02/11/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

UPT kthehu përgjigje, përmes AMS, më datë 22/11/2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 2512/3 Prot., datë 21/11/2022.


GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:

Komenti-1: Çështje e konstatuar nga GVJ në lidhje me, Standardi II.3,

Argumentimi i GVB mbi këtë çështje: GVJ ka vlerësuar paraprakisht në statusin "Përmbushet Kryesisht", por diferenca midis nivelit minimal 10% të përcaktuar nga VKM 41, datë 24.01.2018, dhe gjetja 8.3%, në tërësinë parametrave që këkohen të përmbushen nga Standardi II.3, përbën më pak se 1% të mos-përmbushjes së këtij standarti (Standardit II.3) në tërësinë e kërkesave që nuk përmbushen për këtë program studimi. Si konkluzin i GVB për këtë pikë është se: Standardi II.3 përmbushet në tërësinë e tij në masën 99% dhe shprehim mendimin tonë se ky vlerësim nga GVJ duhet të përkojë me statusin "Përmbushet Plotësisht!"

Përgjigja nga GVJ:

Komenti për kriterin 2 në Standardin II.3 merret parasysht dhe GVJ cilëson vlerësimin për Standardin II.3 në "Përmbushet Plotësisht".



Komenti-2: Çështje e konstatuar nga GVJ në lidhje me Standardin III.5,

Argumentimi i GVB mbi këtë çështje: GVJ ka vlerësuar paraprakisht në statusin "Përbushet Kryesisht", procesi i vlerësimit të vazhduar të studentit bëhet në bazë të kriterëve që janë paraqitur si evidenca:

- Kriteret e vlerësimit të studentëve janë të paraqitura në rregulloren e IAL.
- Në syllabusin e lëndëve është dhënë dhe metoda e vlerësimit të studentit.
- Metoda e vlerësimit është publike dhe studenti është i njohur me të.

GVB konstaton se Rekomandimi që vjen nga GVJ: (copy & paste më poshtë) [Ref_037; 074].

"GVJ rekomandon që të rishikohet vlerësimi me pikëzim dhe gjithçka të jetë e evidentuar në proces verbalin paraprak i cili mbas çdo vlerësimi të jetë në sekretarinë mësimore"

Ky sugjerim mund të diskutohet në departamentin përgjegjës për këtë program studimi që është Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë si një rekomandim të mëtejshëm për përmirësimin e këtij procesi.

Si konkluzin i GVB për këtë pikë është se: Standardi III.5 përbushet në tërësinë tij siç vërtetohet nga evidencat e paraqitura dhe të renditura më sipër, dhe shprehim mendimin tonë se ky vlerësim nga GVJ duhet të përkojë me statusin "Përbushet Plotësisht"

Përgjigja nga GVJ:

GVJ, u qëndron komenteve të plota të cituara në Kriterin (2.3) Standardi III.5, të evidentuara gjatë vizitës në Institucion dhe të diskutura në takimet ditore në Dekanat, Departament, për ç'ka vlerëson Standardin III.5 në "Përbushet Kryesisht".

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” me profili “Energjetikë”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Universiteti Politeknik i Tiranës është i vetmi Institucion i Arsimit të Lartë që ofron programe studimi në fushat inxhinierike, në të tre ciklet e studimit, referuar përkatësisht nivelit të 6-të, 7-të, 8-të të kualifikimit, në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimit.</p> <p>Kjo shprehet qartë në dokumentat bazë të UPT si: neni 3 i Statutit UPT[Ref_001], në Kreun I të Planit Strategjik 2019-2024 të UPT [Ref_010] si dhe në Nenin 5 të Rregullores së Programit të Ciklit të parë të Studimeve Bachelor në Inxhinieri Elektrike [Ref_074].</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Neni 3, pika 3 e Statutit UPT shprehet që qëllimi kryesor i UPT është përparimi i shkencës, i teknologjisë dhe i arsimit të lartë nëpërmjet integritit të tyre si dhe të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë [Ref_001]. Programi studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjetike i studimit i jep të diplomuarit në Inxhinieri Elektrike kompetenca profesionale të mjaftueshme për tu punësuar në ndërmarrjet vendase të prodhimit, shërbimeve dhe në sektorë të ndryshëm industrial.</p> <p>Ky program ka gjithashtu si qëllim të jetë në përmirësim të vazhdueshëm dhe të përafrohet me programet e studimit të ngjashme në BE dhe që përshtaten më mirë tregut dhe kërkesave të sektorit Elektroenergjetik Shqiptar, sektorit të industrisë në Shqipëri, [Ref_074 Neni 17]. Pra si pjesë e ofertës akademike të UPT programi studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike synon të ruajë dhe të forcojë traditën 70 vjecare të përgatitjes së inxhinierëve Elektrike me profil Energjetik në Sistemin Elektrik të Fuqisë në vendin tonë.</p>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Hartimi/riorganizimi i programeve të studimit në UPT mbështetet në tre shtylla kryesore: nevojat e tregut të punës, përvoja dhe eksperiencia e akumuluar në institucion si dhe përvojat e fituara nga bashkëpunimet me universitetet homologe në Europë e më tej.</p> <p>Programet e studimit në UPT ofrohen në përputhje të plotë me misionin e UPT, në fushat inxhinierike të gjeologjisë, burimeve minerare, naftës&gazit, mekanike, materiale, tekstil dhe konfeksione, elektroenergjetike, automatizim industrie, makatronikë, elektronike, telekomunikacion, inxhinieri informatike, inxhinieri matematike, inxhinieri fizike, ndërtim, mjedis, hidroteknikë, gjeodezi dhe në ato të arkitekturës dhe urbanistikës. [Ref_001, Neni 3].</p> <p>Gjithashtu programi i Studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 6

	Profili Energjetike, ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë që mbulojnë këtë program studimi [Ref_008], si dhe në përputhje me strategjinë e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike [Ref_011].			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Misioni i UPT është të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal [Ref_001 Neni 3, pika 1]. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike në Profilin Energjetike në thelbin e tij ka si objektivi kryesor t'u japë studentëve njohuri shkencore themelore në fushën e inxhinierisë dhe më specifike në atë të Inxhinierisë Elektroenergjetike. Programi studimit synon gjithashtu t'u japë studentëve një përgatitje me spektër më të gjerë, veçanërisht në fushën e Inxhinierisë Elektrike, [Ref_074, Neni 5]. Sot nevojat e tregut të punës për profilit e inxhinierit Elektroenergjetik sa vjen dhe shtohet kjo për vetë faktin e gjallërimit dhe rritjes së zhvillimit të sektorit të konsumit të energjise elektrike dhe sektorit industrial në vendin tonë pas kolapsit që pësoi pas viteve 1990.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Universiteti Politeknik i Tiranës, është Institucion Publik i Arsimit të lartë i akredituar, fillimisht me Vendimin e Bordit të Administrimit, BA, Nr. 13, datë 07.04. 2017 dhe riakredituar nga BA me Vendimin Nr. 01, datë 07.01.2022, për periudhën 07/01/2022 deri në 06/01/2028 [Ref_001]</p> <p>FIE me një veprimtari 70-vjeçare, është njësi kryesore në UPT dhe është riorganizuar me VKM Nr. 824, datë 05.12.2007 “Për krijimin e disa njësive kryesore, e fakultete në Universitetin Politeknik të Tiranës” [Ref_008].</p> <p>FIE përbëhet nga tre departamente</p> <p>Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë, si njësi bazë e FIE, përgjegjëse për këtë program studimi plotëson të gjitha kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin 80/2015, duke patur një personel akademik të kualifikuar me tituj e grada shkencore.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit BSc në Inxhinieri Elektrike Profili Energjetike, është hartuar në përputhje me statutin e rregulloret e UPT si dhe në përputhje me aktet rregullatore në shërbim të mbarëvajtjes së programit, evidentimit të cilësisë akademike dhe promovimit të studentëve.[Ref_037].</p> <p>[Ref_037]</p>

<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit përkatës rezulton se UPT ofron programe studimi në fushat inxhinierike siç i ka të përcaktuar në Statut dhe në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular me elemente të hollësishme për programet e studimeve që ofron [Ref_001], [Ref_037]. Rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjetike, është në përputhje me statutin dhe rregulloren e universitetit dhe të fakultetit dhe demonstroi që programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me këto të fundit, [Ref_074 Neni 2].</p> <p>Vërejmë se programi “Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjetike” në thelbin e tij ka si objektivi kryesor t’u japë studentëve njohuri shkencore themelore në fushën e inxhinierisë dhe më specifike në atë të Inxhinierisë Elektrike.</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike, Profili – Energjetikë” që ofrohet nga Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë, është emërtuar, organizuar dhe ka strukturë e përmbajtje në përputhje të plotë me fushat dhe drejtimit akademike të UPT-së [Ref_010].</p> <p>Kjo është në përputhje me fushat studimore që ky departament mbulon dhe shprehet qartë në Rregulloren e programit të studimit ku jepet struktura dhe përmbajtja e programit të studimit dhe në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT [Ref_011]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike, Profili - Energjetikë” [Ref_009], jepen objektivat e përgjithshme dhe ato specifike për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale. Në këtë program studimi ka një ndërthurje midis njohurive teorike, pjesës eksperimentale dhe aftësimi praktik të studentit.</p> <p>Objektivat e përgjithshme të këtij programi studimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ programi ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e Institucionit dhe strategjinë për zhvillimin e tij. ➤ programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. ➤ programi i studimit është i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara nga studenti në një vit është 60 ECTS

	<p>➤ Programi i studimit synon pajisjen e studentit më njohuri bazë mbi metodat dhe parime shkencore të përgjithshme</p> <p>Objektivat specifike janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Gjatë vitit të parë u ofrohet studentëve njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit shkencor ✓ Gjatë dy viteve të tjera akademike, studenti thëllon njohuritë që përkojnë me profilin e diplomës në “Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë” . Synohet për përgatitjen e ekspertëve të aftë për të operuar në këtë fushë, si dhe për mundur të integrohen në institucione me karakter specifik në fushën përkatëse. ✓ Njohuritë e ofruara i krijojnë mundësi studentit për të ndjekur ciklet e tjera në vazhdimësi të studimit, si dhe për të qenë të aftë të aftë të përballen me problematikat që do të ndeshin gjatë realizimit të tyre profesional. ✓ Në përfundim të këtij programi, studenti do të zotërojë konceptet e nevojshme për të trajtuar problematikat e ndryshme në fushën e inxhinierisë elektrike dhe energjitike. <p>Këto objektiva i gjejmë të konkretizuara në kurrikulën që ofrohet, tek organizimi i planit mësimor, ndarja e moduleve në vite, syllabuset, orët teorike dhe ato praktike, laboratorët dhe praktikatat profesionale. [Ref_074].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga vizita në institucion, u konkludua se UPT ndjek dinamikat e zhvillimit të biznesit në vend si dhe universiteteve partnere europiane, duke i monitoruar ato në mënyrë konstante nëpërmjet të cilave orienton edhe programet edukimit. Hartimi/riorganizimi i programeve të studimit në UPT mbështetet në tre shtylla kryesore: nevojat e tregut të punës, përvoja dhe eksperiencia e akumuluar në institucion si dhe përvojat e fituara nga bashkëpunimet me universitetet homologe.</p> <p>Bazë për hartimin e kurrikulave të këtij programi kanë shërbyer: i) programet e ngjashme në Politeknikun e Barit (Itali), ii) analiza e tregut të punës duke u konsultuar me përfaqësues të bizneseve dhe industrisë, duke pasur parasysh nevojat për krijimin e kësaj figure sa me afër industrisë shqiptare. Për këtë qëllim gjatëperiudhës 2020-2021 një pjesë e stafit me përvojë të FIE ka realizuar një studim të hollësishëm për sektorin Elektroenergjitik në Shqipëri, në kuadër të projektit ENGINE Co-founded nga Programi Erasmus + EU. Gjithashtu në kuadër të projektit GRADUA financuar nga Erasmus është realizuar një studim lidhur me tregun e punës në sektorë të ndryshëm të energjitikes dhe industrisë. [Ref_023; 32; 37]</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës, rezulton se ky program studimi i jep të diplomuarit në Inxhinieri Elektrike me Profil Energjitikë kompetenca profesionale të mjaftueshme për tu</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 9

nxënit, garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	punësuar në ndërmarrje dhe përdorimit të energjise elektrike edhe ne sektorin industrial. Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, përmbushin pritshmëritë në fushën e të nxënit si dhe garantojnë përfitim e dijeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Universiteti Politeknik i Tiranës i ri akredituar, fillimet e tij i ka në vitin 1951, i cili përmbante degët inxhinierike Mekanike, Elektrike dhe Inxhinierisë së Ndërtimit. UPT është krijuar si Universitet Politeknik nga VKM Nr. 215, Dt. 15.7.1991 “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës” dhe është Institucion publik i Arsimit të Lartë. [https://online.fliphtml5.com/rvsfy/dytl/#p=19] Aktualisht tre departamentet e FIE (DA, DSEF dhe DE) që bashkëpunojnë për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike me Profil Energjitike, kanë në përbërje të tyre një staf akademik me kohë të plotë prej 30 anëtarësh, nga të cilët 1 Akademike e Asocuar, 3 Prof., 3 Prof. Asoc, 15 Dr. dhe 9 MSc. Në përbërje të këtyre departamenteve janë dhe 7 personel ndihmës akademik. Për zhvillimin e lëndëve të ndryshme për këtë program studimi kontribuojnë edhe njësi të tjera përbërëse të UPT. Gjithashtu FIE angazhon edhe personel akademik me kohë të pjeshme për zhvillimin e disa lëndëve ose pjesëve të lëndëve nga të cilët 3 Prof., 2 Dr. dhe 7 MSc (kryesisht për praktikant mesimore). [Ref_017; 021] dhe Tabelat 1-24
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Një nga fushat didaktike dhe shkencore që mbulon FIE dhe DSEF është Inxhinieria Elektrike, me mision të krijojë, transmetojë, zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të ndryshme; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në fushën e inxhinierisë elektroenergjitike. Veprimtaria akademike e FIE zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës, si dhe kornizën ligjore në fuqi. Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 dhe direktivave e udhëzimeve kombëtare e Evropiane. [Ref_074].

	GVJ konkludon se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore.			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Aktiviteti mësimor kërkimor i realizuar në kuadrin e programit të studimit BSc. në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitike është në përputhje të plotë dhe në të njëjtën linjë strategjike të departamenteve përgjegjëse DA, DSEF, DE si dhe vetë FIE. Gjithashtu objektivat e përgjithshme formuese të programit bachelor në Inxhinieri Elektrike, të parashikuara në Rregulloren e programit të studimit, janë në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë të sipërcituara. Pra ky program studimi është realizuar në përputhje me direktivat dhe udhëzimet Evropiane në mënyrë që të krijohet lidhja natyrale midis programeve të studimit bachelor dhe master, të ndiqet vazhdimësia dhe të garantohet qëndrueshmëria. [Ref_074]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	FIE në hartimin dhe zbatimin e programit mësimor Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profil Energjitike ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi jo vetëm me departamentet brenda tij si njësi kryesore përgjegjëse por dhe me fakultetet dhe departamente të tjera jashtë FIE me qëllim realizimin e misionit dhe detyrave që ka ky program studimi dhe që shprehen në Rregulloren FIE dhe Rregulloren e programit të studimit. Kështu në mbështetje të Nenit 26 të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular të UPT departamentet e FIE para fillimit të vitit të ri akademik bëjnë parashikimin e shpërndarjes së ngarkesës mësimore të stafit të tyre ku përfshihet dhe ngarkesa në programin e studimit në Inxhinieri Elektrike. Ky program është i ndarë në 3 vite akademikë dhe përfshin personel akademik nga 3 fakultete të UPT; Fakulteti i Inxhinierisë matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF), Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM), dhe Fakulteti i Teknologjisë Informacionit (FTI). Stafit akademik i angazhuar është rreth 48 pedagogë që janë pjesë e 11 departamenteve. Strukturat administrative dhe akademike të institucionit bashkëpunojnë me njëra tjetrën. Bashkëpunimi bëhet në kuadër të mësimdhënies, shkëmbimit të stafit akademik, kërkimit shkencor dhe aktiviteve ekstrakurrikulare. Detyrat e stafeve janë të përcaktuara qartë në rregulloret përkatëse të departamenteve, fakulteteve si dhe të njësisë administrative në shërbim dhe në ndihmë të realizimit të programit të studimit. Raportimi për përmbushjen e detyrave bëhet në mënyrë

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 11


	<p>periodike dhe për këtë ekziston një strukturë hierarkike. [Ref_013; 014; 037; 038]</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Nga vizita në Institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezultojnë se për të realizuar objektivat e tij strategjik në rritjen e njohjes ndërkombëtare të diplomave universitare të lëshuar nga UPT, në të gjitha ciklet e studimit, zhvillimin e qëndrueshëm të kapaciteteve njerëzore, IAL ka vendosur marrëdhënie kontraktuale me biznese dhe institucione të ndryshme. Këto marrëveshje bëhen në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore, për efekte të kërkimit shkencor si dhe për të ndihmuar studentët në gjetjen e një vendi pune.</p> <p>Gjate 3 viteve të fundit UPT ka nënshkruar shumë marrëveshje institucionale dhe marrëveshje kuader me bizneset shtetërore dhe ato private falë ndërmjetësimit të stafit akademik.</p> <p>Këto marrëveshje do të shërbejnë jo vetëm për lehtësimin e kryerjes së praktikave të studentëve të dy cikleve por edhe për të forcuar bashkëpunimin në fushën e ekspertizës dhe kërkimit shkencor të stafit të FIE. [Ref_019; 020]</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, departamenti përgjegjës për zbatimin e programit të studimit BSc në Inxhinieri Elektrike Profil Energjitike, në mënyrë të vazhdueshme ka analizuar rezultatet e punës bashkëpunuese dhe përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Në mënyrë të veçantë ka ndjekur rezultatet e punës që kanë rrjedhur nga marrëveshjet e lidhura me institucione të tjera në funksion të kryerjes së praktikave profesionale me studentët për të parë ecurinë e tyre. [Ref_019; 020]</p> <p>Këto kanë qënë objekt i analizave vjetore të punës mësimore të departamentit dhe të fakultetit [Ref_014]. Këto analiza i nënshtrohen diskutimeve të hapura qoftë në nivel departamenti edhe në nivel fakulteti. [Ref_013; 014]</p> <p>Disa nga treguesit e këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit janë: realizimi i praktikave mësimore të studentëve pranë kompanive të ndryshme, realizimi i mobiliteteve të studentëve tanë drejt universiteteve europiane, punësimi i studentëve, realizimi i studimeve shkencore nga stafi akademik, etj.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Nga verifikimi rezultojnë se UPT ka marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi zyrtare për programin e studimit me kompani të sektorit privat dhe institucione /kompani shtetërore, të cilat përdoren jo vetëm për realizimin e praktikave por edhe për të krijuar mundësi të punësimit të studentëve, duke ju rekomanduar atyre studentë për punësim, apo duke informuar studentët për kërkesat e bizneseve. Kjo lidhje dhe bashkëpunim zgjerohet nga viti në vit.</p> <p>Praktika profesionale ndiqet dhe nga personeli akademik, anëtarë të KPS-së për këtë program studimi si dhe specialistet udhëheqës në vendin e punës. [Ref_019; 020]</p>



Handwritten signature in blue ink.


<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga studimi i marrë nga zyra e karrierës dhe alumni në FIE rezultoi se IAL ka firmosur marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional me Istitucione shtetërore dhe private të fushës së studimit, ku nëpërmjet tyre mbështet trajnimin profesional të mëtejshëm të studentëve. Nëse kërkohet nga punëdhënësit, UPT bashkëpunon me to duke ofruar trajnime të mëtejshme për studentët e diplomuar në këtë program studimi</p> <p>Gjithashtu, Universiteti Politeknik ofron kurse të formimit të vazhduar, me synimin plotësim, thellim dhe freskim të njohurive të studentëve. Në tre vitet e fundit ka rritje të numrit të kurseve të formimit të vazhduara që organizohen. Këto programe janë në përputhje me kërkesat e ministrisë së linjës dhe u shërbejnë të interesuarve për t'u pajisur me certifikata kompetence ose leje ushtrimi profesioni. Universiteti synon drejt shtrirjes së programeve të studimit të formimit të vazhduar në llojshmëri dhe në fusha të ndryshme inxhinierike. Nga studimi i marrë nga zyra e karrierës dhe alumni në FIE si dhe sekretaria mësimore shihet qarte se shumica e studentëve, të cilët diplomohen në këtë program studimi vazhdojnë studimet në programet e ciklit të dytë dhe një numër i vogël punësohen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	--

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR


Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga vizita rezulton se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike profili Energjitik zhvillohet në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fuqi. Ai është i organizuar në module dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti, nga një student që ndjek këtë program studimi është 60 kredite.</p> <p>Programi ofrohet me 180 ECTS, me kohëzgjatje normale të parashikuar 3 (tre) vite akademike.</p> <p>Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e provimit të formimit. Mësimi realizohet në gjuhën shqipe. Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë. Në versionin aktual të tij, ky program është riformatuar dhe riorganizuar në përputhje të plotë me VKM. Nr. 41, datë 24.1.2018” Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar. [Ref_074]</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë”, si: Plani mësimor, Syllabuset, Rregullorja e programit të studimit, si dhe gjatë takimit me personelin akademik dhe studentët, u konstatua se ky program studimi u ofron studentëve njohuri, të cilat do të jenë të nevojshme edhe për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit.</p> <p>Shihet qartë që programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. Programi u përgjigjet kërkesave, me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional.</p> <p>Program i ciklit të parë të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë zhvillon një mënyrë të re të menduar për analizimin dhe zgjidhjen e problemeve inxhinierike, optimizuese dhe teknike në sistemet elektrike të fuqisë. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë ofron formim në fushat inxhinierike dhe veçanërisht ato elektrike dhe sistemeve të fuqisë. Në tre vite studimin, studenti merr njohuri bazë teorike si edhe njohuritë më të thelluara të nevojshme për të qenë të aftë për punë ndërdisiplinore.</p> <p>[Ref_074, 5] Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) Energjitikë DSEF, Neni 5].</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë” na rezulton se ky program studimi i krijon studentit hapësirën e mjaftueshme për thellimin e dijeve</p>

<p>punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>në disiplina ku ai shpreh interes. Kjo realizohet nëpërmjet të drejtës të studentit për të zgjedhur, lëndët me zgjedhje sipas planit mësimor.</p> <p>Studentët që ndjekin këtë program studimi janë të aftë të punojnë në rrjetat elektrike të shpërndarjes, projektimit të furnizimit me energji elektrike të ndërmarjeve industriale e civile, teknologjitë e reja në sistemin elektroenergjitik, rrjetet smart dhe komunikimit në sistemin elektroenergjitik dhe të sektorit elektrik nëpërgjithësi. Formojnë aftësi të nevojshme për projektimin rrjetit elektrik shpërndarës, rrjetave të furnizimit me energji elektrike të ndërmarjeve dhe proceseve, që janë të lidhura ngushtë me fushën e mbrojtjes dhe automatizimit të Sistemit Elektroenergjitik dhe rrjetave të tjera të furnizimit me energji elektrike. Janë të aftë të kryejnë eksperimente, të analizojnë dhe interpretojnë të dhënat e marra prej tyre. Fitojnë aftësi vendimmarrëse dhe komunikimi, etj.</p> <p>Njohuritë e marra janë bashkëkohore dhe të krahasueshme me nivelin e njohurive që jepen në programe të ngjashme inxhinjrike në universitete të tjera.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë ka synim të tij paisjen e studentëve me dijet e nevojshme profesionale dhe aftësimin e tyre për zgjidhjen e problemeve në fushën e inxhinierisë elektrike dhe atë të sistemeve elektrike të fuqisë. Në rregulloren e programit të studimit jepen qartësisht dhe kompetencat e fituara nga ky program.</p> <p>Këto njohuri bazë thellohen më tej gjatë studimit në programet master shkencor apo profesional.</p> <p>Në veçanti, të diplomuarit në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë janë në gjendje, që me nivelin e njohurive të kërkuara prej tyre, të identifikojnë dhe të kuptojë një problem specifik të inxhinierisë elektrike, të përcaktojnë qartë aspektet themelore të tij, të shqyrtojnë në mënyrë kritike metodat e mundshme të konsoliduara për përballimin dhe zgjidhjen e tij, të identifikojë më të përshtatshmet për kontekstin specifik dhe të përcaktojnë kriteret për zbatimin e tij, etj.</p> <p>Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e përfituara nga studenti detajohen për çdo lëndë në syllabuset e tyre.</p> <p>Nga takimet me stafin akademik dhe studentë të këtij programi studimi, GVJ konkludon se njohuritë e marra e aftësojnë studentin për t'u integruar në kohë të shkurtër në kompanitë e ndryshme të profilit brenda dhe jashtë vendit dhe hedh bazat për zhvillimin e studimeve më të avancuara. [Ref_018; 074]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Plani mësimor, Syllabuset dhe rregullorja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë përmbajnë të gjithë elementët përshkrues të programit të studimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Për të gjitha lëndët/modulet janë dhënë ngarkesa në kredite, format e ndryshme të mësimdhënies, orët mësimore në auditor dhe ngarkesa jashtë auditorit, kategoria të cilës i përket, kodi i lëndës, etj. [Ref_018]</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë</p>	<p>Veprimtaritë formuese të BSc në Inxhinieri në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë trajtohen hollësisht në Nenet 7 dhe 8 të Rregullores</p>

<p>veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>së programit të studimit. Pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda këtij programi studimi, e shprehur në përqindje të krediteve të alokuara, përcaktohet si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. lëndë bazë (A) – 18.3%, 2. lëndë karakterizuese (B) – 53.3%, 3. lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 15%, 4. lëndë plotësuese (D) – 8.3%, 5. detyrime përmbyllëse (E) – 5%. <table border="1" data-bbox="614 510 1193 857"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Kriteri Bachelor (VKM 41, date 24.1.2018)</th> <th>% ECTS</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>15 – 20 %</td> <td>18.3%</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>50 – 55 %</td> <td>53.3%</td> </tr> <tr> <td>A+B</td> <td>≥ 70%</td> <td>71.7%</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>12 – 15 %</td> <td>15%</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>10 – 15 %</td> <td>8.3%</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>3 – 5 %</td> <td>5%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjithashtu përkatësia e veprimtarive formuese si dhe ngarkesa në kredite dhe shpërndarja e tyre në çdo lëndë jepen dhe në planin mësimor të programit të studimit.</p> <p>Kreditet e grumbulluara për çdo kategori në përgjithësi janë brenda raporteve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. [Ref_018;074].</p>	Kategoria	Kriteri Bachelor (VKM 41, date 24.1.2018)	% ECTS	A	15 – 20 %	18.3%	B	50 – 55 %	53.3%	A+B	≥ 70%	71.7%	C	12 – 15 %	15%	D	10 – 15 %	8.3%	E	3 – 5 %	5%
Kategoria	Kriteri Bachelor (VKM 41, date 24.1.2018)	% ECTS																				
A	15 – 20 %	18.3%																				
B	50 – 55 %	53.3%																				
A+B	≥ 70%	71.7%																				
C	12 – 15 %	15%																				
D	10 – 15 %	8.3%																				
E	3 – 5 %	5%																				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X													
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht																			
			X																			

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Universiteti Politeknik i Tiranës, është Institucion Publik i Arsimit të lartë i akredituar, fillimisht me Vendimin e Bordit të Administrimit, BA, Nr. 13, datë 07.04. 2017 dhe riakredituar nga BA me Vendimin Nr. 01, datë 07.01.2022, për periudhën 07/01/2022 deri në 06/01/2028</p> <p>Njësia kryesore përgjegjëse për këtë Program Studimi është Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, i cili përbëhet nga 3 njësi bazë, të cilat plotësojnë kriteret ligjore për funksionim, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë 2. Departamenti i Automatikes 3. Departamenti i Elektroteknikës <p>➤ Departamenti i Sistemeve Elektrike të fuqisë përgjegjës për Programin mesimor BSc në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë aktualisht ka një personel akademik prej 8 anëtarësh, prej të cilëve 2 Akademik Prof. Dr., 1 Doktor, 5 Master i Shkencave si dhe 2 personel ndihmës akademik duke plotësuar të gjitha kriteret ligjore. Gjithashtu departamenti ka edhe personel akademik me kontratë,</p>




	<p>përkatësisht 3 (PAK) ku në përbërje janë 2 Dr dhe 1 Msc.</p> <p>➤ [Ref_003; 017; Tabela1&2]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se: Programi i ciklit të parë të Studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjistikë organizohet dhe menaxhohet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS), i cili përbëhet nga 5 anëtarë. Anëtarët e KPS propozohen nga departamentet që bashkëpunojnë për këtë program studimi dhe miratohen në Dekanatin e FIE. Një anëtar përzgjidhet nga radhët e studentëve. Personeli akademik, anëtar i KPS është të paktën i kategorisë “Lektor” me përvojë, jo më pak se 10 vjet në mësimdhënie pranë Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë dhe është mësimdhënës në programin përkatës të studimit. Drejtuesi i KPS është koordinatori i programit të studimit.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e vendosura.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit dhe KPS informojnë vazhdimisht drejtuesin e departamentit dhe bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, në përputhje me rregulloren e njësisë bazë dhe kryesore. [Ref_008; 009; 037;074; 137]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FIE si njësi kryesore dhe Departamentet bashkë organizuese si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili Energjistikë, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>FIE përbëhet nga njësitë bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Automatikës 2. Departamenti i Elektroteknikës 3. Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë <p>Njësi ndihmëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sekretarinë mësimore 2. Dega e financës 3. Dega e këshillimit të karrierës dhe Alumni 4. Qendra multimediale <p>FIE ka strukturë akademike në përputhje të plotë me Udhëzimin Nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, pika 6.</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Asambleja e personelit akademik b) Dekanati c) Dekani d) Zv. Dekanët <p>Pra organizimi dhe struktura akademike e FIE dhe departamenteve përbërës është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit</p>	<p>Bazuar në verifikimin e dokumentacionit rezulton se njësia kryesore /bazë përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin e strukturës akademike.</p> <p>FIE si njësi kryesore që ofron Programin e Studimit në Inxhinieri Elektrike Profili Energjistikë, duke ju referuar kërkesave ligjore e</p>

<p>akademik.</p>	<p>tejkalon minimumin e kualifikimeve të kërkuara nga LAL. Po kështu edhe anëtarët e tjerë jashtë FIE kanë kualifikimet e mjaftueshme të kërkesave të nivelit bachelor në fushat që ata mbulojnë Kështu 3 departamentet përgjegjës për ofrimin e këtij programi kanë numrin dhe kualifikimin e personelit akademik si më poshtë:</p> <p>Për vitin aktual 2021-2022, personeli akademik në FIE përbëhet si me poshte:</p> <table border="1" data-bbox="726 425 1292 660"> <thead> <tr> <th></th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Profesor</td> <td>4</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc</td> <td>3</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Doktor/Docent</td> <td>13</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>10</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td></td> <td>30</td> <td>13</td> </tr> </tbody> </table> <p>Pra FIE dhe njësitë bazë përgjegjëse për PS Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë plotësojnë detyrimet ligjore për numrin dhe kualifikimin e stafit akademik.</p> <p>Ndërsa stafi akademik mësimdhënës në këtë program përbëhet nga 60 pedagogë, nga të cilët: 4 Prof. Dr., 6 Prof. Asoc., 30 Dr., dhe 20 MSc. Ku 48 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 12 staf i ftuar (PAK).</p> <p>Njësia bazë (DSEF) përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë ka personel akademik prej 8 anëtarësh nga keta:</p> <p>2 Akademik Prof. Dr., 1 Doktor, 5 Master i Shkencave si dhe 2 personel ndihmës akademik duke plotësuar të gjitha kriteret ligjore. Gjithashtu departamenti ka edhe personel akademik me kontratë, përkatësisht 3 (PAK) ku në përbërje janë 2 Dr dhe 1 Msc.</p> <p>[Ref_017 Tabela 7; Ref_129].</p>					PAE	PAK	Profesor	4	2	Prof. Asoc	3	1	Doktor/Docent	13	3	Msc.	10	7		30	13
	PAE	PAK																				
Profesor	4	2																				
Prof. Asoc	3	1																				
Doktor/Docent	13	3																				
Msc.	10	7																				
	30	13																				
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FIE, si njësi kryesore dhe njësitë bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Autoritet drejtuese në FIE janë Dekani dhe Përgjegjësit e Departamentit me gradat e titujt përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Autoritete të tjera janë Zv. Dekanët.</p> <p>Pra organizimi dhe struktura akademike e FIE dhe departamenteve përbërës është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor.[Ref_003; 008].</p>																					
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p>X</p>																		

<p>Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin,</p>	<p>FIE dhe 3 departamentet përgjegjëse për Programin e Studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë, disponojnë gjithë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi.</p> <p>Nga vizita në auditor si dhe dokumentat e vëna në dispozicion në</p>

strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	dosjen e vlerësimit, vërehet se në departamente ishin të depozituara dhe të dokumentuara, plani mësimor i programit të studimit, syllabuset e lëndëve, Rregullorja e programit të studimit dhe Lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të aktivizuar në vite në mësimdhënje në këtë program studimi. Në fillim të çdo viti mësimor bëhet shpërndarja e ngarkesës mësimore dhe përgatitet dhe orari mësimor. [Ref_018; 037; 074; 088]																					
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	<p>Kurrikula e programit të studimit, është e organizuar në lëndë, praktikë dhe trajnim profesional, të cilat janë të grupuara sipas kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ LËNDË BAZË, ose lëndë të kategorisë A. ✓ LËNDË KARAKTERIZUESE, ose lëndë të kategorisë B. ✓ LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE. ✓ LËNDË PLOTËSUESE. ✓ DETYRIME PËRMBYLLËSE. <table border="1" data-bbox="644 734 1225 1084"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Kriteri Bachelor (VKM 41, date 24.1.2018)</th> <th>% ECTS</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>15 – 20 %</td> <td>18.3%</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>50 – 55 %</td> <td>53.3%</td> </tr> <tr> <td>A+B</td> <td>≥ 70%</td> <td>71.7%</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>12 – 15 %</td> <td>15%</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>10 – 15 %</td> <td>8.3%</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>3 – 5 %</td> <td>5%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>GVJ rekomandon të rishikohet përmbajtja lëndore dhe pesha e tyre në ECTS në plan programin mësimor, në mënyrë që edhe tipi i veprimtarisë lëndë plotësuese (D) të jetë brenda kriterëve të përcaktuara, (10-15% nga 8.3% qe rezulton aktualisht).</i> [Ref_018; 074]</p>	Kategoria	Kriteri Bachelor (VKM 41, date 24.1.2018)	% ECTS	A	15 – 20 %	18.3%	B	50 – 55 %	53.3%	A+B	≥ 70%	71.7%	C	12 – 15 %	15%	D	10 – 15 %	8.3%	E	3 – 5 %	5%
Kategoria	Kriteri Bachelor (VKM 41, date 24.1.2018)	% ECTS																				
A	15 – 20 %	18.3%																				
B	50 – 55 %	53.3%																				
A+B	≥ 70%	71.7%																				
C	12 – 15 %	15%																				
D	10 – 15 %	8.3%																				
E	3 – 5 %	5%																				
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Kurrikula e programit mësimor Bsc. në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë ka të organizuara lëndët të ndara në vite akademike dhe semestra. Ky program studimi zgjat 3 (tre) vite akademike me 180 kredite ECTS. Gjithashtu lëndët janë të vlerësuara në kredite sipas sistemit European të Transferimit të Krediteve ECTS. Kreditet ECTS janë të pasqyruara edhe në syllabusin përkatës të cdo lënde. [Ref_018].																					





<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë ka Planin Mësimor i cili është i organizuar në vite akademike dhe semestral. Në të parashtrihen në mënyrë të përmbledhur karakteristikat e kërkuara nga VKM 41, datë 24.01.2018 dhe elementet e tjera përshkruese. Plani mësimor hartohet/rishikohet nga KPS-ja, miratohet paraprakisht nga departamenti, kontrollohet dhe miratohet nga dekanati i njësisë kryesore, vlerësohet për plotësimin e standardeve nga Drejtoria e Kurrikulave dhe miratohet nga SAUPT para fillimit të vitit përkatës akademik. [Ref_018]</p> <p>GVJ konstaton se Programet lëndore, syllabuset, e programit të studimit janë unifikuar në nivel IAL-je. Në syllabuse gjithashtu, përshkruhet mënyra në kontrollin e njohurive dhe vlerësimit të dijeve, e cila ndryshon nga njëra lëndë në tjetrën në përputhje me veprimtaritë e ndryshme të parashikuara. [Ref_088].</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga takimet në Istitucion dhe verifikimi i dokumentacionit rezulton se në rregulloren e “Regjistrimeve dhe transferimeve” të UPT-së jepen informacionet e nevojshme për pranimin e studentëve në ciklin e parë, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Gjithashtu neni 19 i Rregullores zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT jep informacionin dhe kriteret e përgjithëshme për pranimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve.</p> <p>Kandidatët në këtë program studimi konkurojnë nëpërmjet sistemit u-albania, ku Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) koordinon procesin e aplikimit të kandidatëve. Lista me renditjen e kandidatëve afishohet në mjediset publike të njësisë kryesore, në faqen zyrtare të njësisë kryesore dhe të UPT-së. [Ref_037; 074]</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se plani mësimor i programit të studimit jep informacione rreth lëndëve që zhvillohen dhe strukturës së tyre. Ndërsa dosja e plotë e programit të studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Programet lëndore (syllabus-et) përmbajnë informacionet e nevojshme në përputhje të plotë me VKM nr. 41, elementet sipas përcaktimeve në Anekset e RVB. Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës ose grup lektorësh të lëndës, rishikohet nga KPS në njësinë bazë përgjegjëse për programin përkatës të studimit dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe dekan i fakultetit (ose dekanët e dy fakulteteve, kur programi i studimit dhe disiplina përkatëse administrohen nga fakultete të ndryshme). [Ref_017, Tabela14; 018].</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale</p>	<p>Me qëllim reflektimin e kërkesave të tregut të punës, përvojave më të mira nga universitetet homologe europiane, ndryshimet e objektivave dhe strategjive kombëtare, programet e studimit janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Procedura e rishikimit të programit të studimit në masën jo më shumë se 20% jepen të detajuara në</p>


dhe arkivohet dosja e plotë.	Nenin 16 të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular të UPT. Plani mësimor hartohet/ rishikohet nga KPS-ja, miratohet paraprakisht nga departamenti, kontrollohet dhe miratohet nga dekanati i njësisë kryesore, vlerësohet për plotësimin e standardeve nga Drejtoria e Kurrikulave dhe miratohet nga SAUPT para fillimit të vitit përkatës akademik. Në tre vitet e fundit akademike plani mësimor i programit të studimit Bachelor “Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitike” nuk ka ndryshuar, ndërsa përmbajtja e programeve lëndorë është përmirësuar me qëllim ndjekjen e të trendit të zhvillimit të teknologjisë. [Ref_037; 059- Tabela 11;119].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4																																
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.																																
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																															
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Nga verifikimi rezulton se ngarkesa e programit mësimor është në përputhje me aktet ligjore.</p> <p>Për programet e studimit të ciklit të parë Bachelor në UPT, raporti kredite /orë mësimore në auditor dhe punë e pavarur është caktuar në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe të mësimdhënies të miratuar nga SAUPT si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Aktiviteti</th> <th>Numri i krediteve</th> <th>Orë në auditor</th> <th>Orë studim individual</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Leksion</td> <td>1 ECTS</td> <td>12</td> <td>13</td> </tr> <tr> <td>Seminar</td> <td>1 ECTS</td> <td>14</td> <td>11</td> </tr> <tr> <td>Laboratorë</td> <td>1 ECTS</td> <td>20</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Projekt/detyra</td> <td>1 ECTS</td> <td>5</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Praktika</td> <td>1 ECTS</td> <td>20</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Diploma</td> <td>1 ECTS</td> <td>5</td> <td>20</td> </tr> </tbody> </table> <p>Programi i studimit dhe ngarkesa mësimore që ai përmban është hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse, kryesisht VKM nr. 41, datë 24.01.2018.Struktura dhe organizimi i programit të studimit të nivelit të parë është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve: Niveli 6; Programe studimi Bachelor (Diplomë Universitare).Programi i studimit shtrihet në tre vite akademike, i ndarë në 6 semestra, i organizuar mbi bazën e lëndëve ose moduleve dhe i vlerësuar me kredite (ECTS).</p> <p>Çdo semestër ka 14 javë mësimore. Ora mësimore është 50 minuteshe. Organizimi i procesit mësimor për çdo program studimi shprehet në orarin mësimor, i cili shpallet nga dekanati i Fakultetit. [Ref_018].</p>				Aktiviteti	Numri i krediteve	Orë në auditor	Orë studim individual	Leksion	1 ECTS	12	13	Seminar	1 ECTS	14	11	Laboratorë	1 ECTS	20	5	Projekt/detyra	1 ECTS	5	20	Praktika	1 ECTS	20	5	Diploma	1 ECTS	5	20
Aktiviteti	Numri i krediteve	Orë në auditor	Orë studim individual																													
Leksion	1 ECTS	12	13																													
Seminar	1 ECTS	14	11																													
Laboratorë	1 ECTS	20	5																													
Projekt/detyra	1 ECTS	5	20																													
Praktika	1 ECTS	20	5																													
Diploma	1 ECTS	5	20																													

<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë është tradicional qe ka ofruar FIE në vite. Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe e praktikave mundësojnë njohuri bashkëkohore dhe atraktive për studentët, ato janë të organizuara sipas objektivave të formimit dhe mundësojnë marrjen e njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme si dhe punësimin. Programi i studimit me përvojë të gjatë ka për qëllim tu japë studentëve bazat teorike dhe praktike të inxhinierisë elektrike-energjitike. Nga të dhënat e zyrës së karrierës dhe alumnit vihet re se shumica e studentëve, të cilët përfundojnë këtë program studimi vazhdojnë programet e ciklit të dytë Master Profesional apo Master i Shkencave të ofruara nga institucioni. Studentët të cilët arrijnë të kenë një përgatitje të mirë gjatë periudhës trevjeçare u krijohet mundësia të integrohen në tregun e punës.[Ref_074, Neni 5, 7&8]</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimit profesional.</p>	<p>Nga verifikimi i programit mësimor rezulton se, lëndët dhe modulet janë shpërndarë përgjatë 3 viteve dhe 6 semestrave në mënyrë korrekte. Në këtë formë mundësohet formimi gradual i studentëve. Në vitin e parë bëhen kryesisht lëndë të formimit bazë, nëpërmjet të cilave, studentët marrin njohuritë bazë në fushat e matematikës, fizikës, kimisë, informatikës, programimit. Në vitin e dytë dhe të tretë merren njohuri të lidhura ngushtësisht me fushën e studimit. Ndërtimi i planit mësimor është bërë duke respektuar piramidën e dijeve, pra disiplinat paraardhëse të shërbejnë si bazë për marrjen e njohurive në disiplinën pasardhëse. Disiplinat në planin mësimor, sasia e krediteve dhe e orëve të vëna në dispozicion për secilën disiplinë, syllabuset e tyre bëjnë të mundur që në përfundim të programit të studimit të jenë arritur objektivat formuese të këtij program studimi dhe rezultatet e të nxënimit.[Ref_074, Neni 5].</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, vërehet se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë është strukturuar në përputhje me praktikën më të mira në rajon, duke u mbështetur kryesisht në modelet e universiteteve teknike italiane dhe në mënyrë specifike sipas modelit të Politeknikut të Milanos dhe Barit. Programi i studimit Bsc. në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë, në strukturën e tij është në përputhje të plotë me (VKM Nr 41. datë 24.01.2018, “Për elementët e programit të studimit”), ku pesha dhe ngarkesa e veprimtarive formuese, e shprehur në kredite është në përputhje të plotë me veprimtaritë formuese të parashikuara për programet e studimit të ciklit të parë, të parsqyruara në shtojcën Nr 1, të kësaj VKM-je. Lëndët në programin mësimor përmbajnë aspekte teorike (leksione) dhe aspekte praktike (seminare, ushtrime, laboratorë), ku për pjesën më të madhe të lëndëve raporti teori-praktikë është në vlerat 50:50%. [Ref_018].</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e</p>	<p>GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese e programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike, Profili - Energjitikë” është në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar, përvec tipologjisë D , tipi i veprimtarisë lëndë plotësuese të jetë brenda</p>

objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	kriterëve të përcaktuara 10-15% nga 8.3% që rezultojn aktualisht nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, siç është vënë në dukje edhe më sipër. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik e këtij programi studimi mundësojnë arritjen e objektivave formues të tij, të shprehura në rregulloren e programit të studimit Ngjashmëria midis këtij programi studimi dhe programeve të tjera e brenda dhe jashtë vendit mundësojnë transferimin e studimeve dhe mobilitetin e punësim të studentëve. Transferimet janë kryer brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. [Ref_018]
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Programet disa lëndëve/moduleve karakterizuese janë objekt i diskutimeve për përditësimin e tyre duke u bazuar në literaturën më të re të detyruar dhe ndihmëse, preferohen 5 vitet e fundit. Gjithashtu stafi dhe departamentet çdo vit akademik bëjnë porosi në Bibliotekën Shkencore të UPT ose kërkojnë në buxhetin e FIE të blejnë literaturën përkatëse të lëndëve të tyre gjë që u konstatua edhe nga vizita në institucion. Eksperiencat dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, si dhe mobilitet e stafit akademik të FIE, në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, kanë ndikuar në pasurimin dhe përmirësimin e syllabuseve. [Ref_018; 024; 049]. <i>GVJ sugjeron që personeli akademik i këtij programi studimi të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të hartuar dhe rifreskuar ciklet e leksioneve për disa lëndë profesionale që nuk kanë tekste të rifreskuara në gjuhën shqipe.</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Duke ju referuar syllabuseve të lëndëve tek pjesa “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënimit” shihet që programi i studimit në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë ka përmbajtje didaktike, profesionale dhe shkencore shumë formuese dhe garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli bachelor. Përmbajtja e programit u mundëson dhe u garanton studentëve përfundimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave profesionale, të cilat përbëjnë edhe synimet kryesore të këtij programi të përcaktuara edhe në Rregulloren e studimeve të programit. [Ref_018; 074].
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Ky program mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në në programet e ciklit të dytë Master. Këtë gjë e vërteton edhe fakti i egzistencës së gjashtë programeve të studimit në nivelin Master (MSc dhe MP) në fushën e inxhinierisë elektrike, brenda FIE. Gjithashtu synohet t’u ofrohet studentëve perspektiva më të mira lidhur me përshtatjen, fleksibilitetin dhe integrimin në tregun e punës. Ky program studimi i jep të diplomuarit në Inxhinieri Elektrike kompetenca profesionale të mjaftueshme për tu punësuar në sektorin privat dhe publik të prodhimit të energjisë elektrike, të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe në të gjithë aktoret që operojnë në tregun e energjisë elektrike. [Ref_074].
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të	Nga vizita në institucion rezultoi se programi mësimor është ndërtuar duke u konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e

studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës në fushën e inxhinierise elektrike. Studentët që kanë realizuar praktikën në këto kompani plotësojnë një pyetësor në lidhje me praktikën dhe problematikat që kanë hasur dhe kanë patur vështërsi, të cilat më pas reflektohen në syllabuset e lëndëve përkatëse. IAL është përpjekur të implementojë propozimet e tyre. [Takimi me dekanin dhe përgjegjësen e departamentit]. [Ref_014; 023].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Stafi akademik PAE dhe PAK, i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin e duhur dhe konstatohet se personeli akademik i përfshirë në mësimdhënie ka qëndrueshmëri. Në realizimin e programit të studimit në Inxhinieri Eelektrike sipas planit mësimor të miratuar janë të përfshirë 60 pedagogë, nga të cilët: 4 Prof. Dr., 6 Prof. Asoc., 30 Dr., dhe 20 MSc. Nga të cilët 48 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 12 staf i ftuar (PAK), duke përmbushur në këtë mënyrë të gjitha kërkesat sipas legjislacionit në fuqi. GVJ konstaton se ngarkesa mësimore vjetore PAE në auditor është në përputhje të plotë me Udhëzimet e MAS, ku orët shtesë në auditor nuk i kalojnë 200 orë mësimore në funksion të pozicionit në DA/FIE/UPT dhe titull/gradë. PAK janë të ngarkuar deri në 120 orë. [Ref_018; 017; 025; 026]
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Për vitin akademik 2021-2022, personeli akademik efektiv (PAE) përgjegjës për këtë program studimi përbëhet nga 53 vetë ku 3 mbajnë titullin “Prof. Dr.”, 7 “Prof As”, 31 mbajnë gradën “Dr” dhe 12 mbajnë diplomën Master i Shkencave. Përsa i përket personelit akademik me kontratë (PAK), ata janë 12 personel ku 1 mban titullin “Prof. Dr.”, 1 “Prof As”, 1 gradën “Dr” dhe 9 mbajnë diplomën Master i Shkencave. Nga verifikimi në institucion rezulton se programi mësimor është realizuar nga personel akademik me kualifikimin e nevojshëm. Personeli me gradë Msc është i angazhuar vetëm në zhvillimin e ushtrimeve dhe punëve laboratorike, ndërsa zhvillimi i leksioneve kryhet vetëm me personel akademik me tituj dhe gradë shkencore. [Ref_017; Tabela_1, 2 & 7]
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e	Nga verifikimi i dokumentacionit dhe takimi me stafin, rezulton se personeli akademik ka nivelin e duhur të kualifikimit në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të programit të studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Kualifikimi i stafit akademik, që vjen nga departamentet e tjera të UPT është në përputhje me me natyrën dhe specikën e lëndës, që mbulojnë.

studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.				
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, me kompani të cilat operojnë në fushën e inxhinierise elektrike. Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë si qëllim njohjen e tregut të punës dhe realizimin e praktikave mësimore.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se praktika mësimore kryhet pranë kompanisë dhe nën drejtimin e një pedagogu. Pedagogu përgjegjës caktohet nga departamenti. Një pedagog ka në mbikëqyrje një numër prej 20 studentësh.</p> <p>Në kuadër të marrëveshjeve për praktikën mësimore, parashikohet përcaktimi nga ana e institucionit pritës i një udhëheqësi të praktikës, i cili të kontrollojë dhe të informojë mbi mbarëvajtjen e saj.</p> <p>Gjithashtu edhe për realizimin e provimit të formimit FIE ka miratuar dhe zbaton një procedurë të veçantë.</p> <p>Objekt i kësaj procedure është vendosja e kushteve për mënyrën e konceptimit, formulimit dhe hartimit të fondit të pyetjeve, hartimit të tezës së provimit të formimit, Komisioneve të mbikëqyrjes, Komisioneve të Korrigjimit dhe Komisioneve të Vlerësimit të Provimit të Formimit, në programet e ciklit të parë të studimeve (Bachelor) në FIE. Detyrimi përmblyës për këtë program studimi është provimi përfundimtar. [Ref_042; 020; 074]</p>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Nga verifikimi rezultoi se institucioni ka të angazhuar personel akademik ndihmës sipas natyrës specifike të programit të studimit. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Detyrat e stafit ndihmës akademik përcaktohen në Nenin 33 të Rregullres së brendshme të FIE. Detyra të tjera specifike sipas natyrës së departamenteve, lëndëve që mbulojnë me laboratorë etj, përcaktohen nga drejtuesit e njësive bazë dhe në rregulloret e tyre. Tre departamentet e FIE që janë përgjegjëse për PS, kanë aktualisht një staf ndihmës akademik prej 7 (shtatë) asistente pedagogë. [Ref_009; 017; 074; 128]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Nga vizita në institucion u verifikua se institucioni ka hartuar një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Në bazë të udhëzimit lejohet përdorimi i metodave kompjuterike gjatë mësimdhënies (power point, projektor, programe të ndryshme kompjuterike). Por bazuar dhe në periudhën e vështirë të vitit akademik 2019-2020, si rezultat i pandemisë COVID19, IAL ka hartuar dhe vënë në funksionimi metodën e mësimi on-line duke përdorur fillimisht programet Google classroom dhe Zoom. Në veçanti, moduli “Microsoft Teams”, ka gjetur një përdorim të gjerë në periudhën e pandemisë për vitin akademik 2020-2021. Për tu ardhur në ndihmë studenteve që nuk mund të kishin gjithmonë një lidhje on-line u bë e mundur që leksionet, seminarët dhe elementë të tjerë të përfshirë në programet e lëndëve të vihen në dispozicion edhe në format video të regjistruar, me qëllim përdorimin e tyre edhe off-line. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezultojnë se Plani Strategjik 2019-2024, Kreu VI.5, “Zhvillimi i infrastrukturës digjitale për përmirësimin e edukimit dhe krijimin e oportuniteteve për personelin akademik”, përcakton se UPT synon të jetë lider në drejtim të përdorimit të IT në të gjithë veprimtarinë e tij duke mbështetur përpjekjet për zhvillimin e infrastrukturës dixhitale në shërbim të mësimi me pikësnyim rritjen e përdorimit të software për zhvillim profesional të personelit akademik dhe të studentëve. Gjithashtu, në zbatim të ligjit Nr. 9704, datë 02.04.2007 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telematik për universitetet”, si dhe në vijim të VKM nr. 236, datë 02.04.2007 “Për krijimin e Qendrës Ndëruniversitare të Zhvillimit të Telematikës” dhe marrëveshjes ndërmjet universiteteve publike dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës është implemuar dhe është ngritur infrastruktura hardware për instalimin lokal të sistemit bit-Albania. Ky sistem ka vite që është testuar tashmë në UPT dhe aplikohet në Fakultetin e Inxhinierisë elektrike përmes platformës https://bit-albania.com.</p> <p>[Ref_010; 055; 083]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë</p>	<p>Nga vizita në institucion u vërejt se në “UPT” janë ngritur dhe funksionojnë strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe kontrollit të cilësisë si “Njësinë Qendrore e Sigurimit të Cilësisë” (NJQSC) ose Drejtorinë e</p>

<p>mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC), e ngritur në rektoratin e UPT dhe “Njësitë e Sigurimit të Cilësisë” (NJSC) në çdo njësi kryesore të UPT Këto njësi në bashkëpunim të ngushtë me njësitë bazë, monitorojnë në vazhdimësi plotësimin e standardeve të cilësisë në mësimdhënie nga stafi akademik dhe ai ndihmës akademik, përmes vlerësimeve semestrale të studentëve dhe raporteve semestrale të vetë pedagogëve. Stafi akademik i FIE, departamentet dhe FIE në përfundim të çdo viti akademik bëjnë analizën e punës së tyre mësimore. Përmes analizës, përcaktohen edhe objektivat për përmirësimin e performancës së personelit dhe të cilësisë në mësimdhënie. Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka kryer rregullisht edhe anketimin semestral studentor mbi cilësinë në mësimdhënie. [Ref_014; 031; 032]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, dakordësojmë se UPT garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. [Ref_032; 037] https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSceQbCS_-</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se struktura përgjegjëse bën publike dhe informon departamentin në lidhje me rezultatet e vlerësimit të brendshëm. Departamenti i analizon rezultatet në një mbledhje të veçantë. Rastet specifike, apo shqetësuese diskutohen personalisht me personat e interesuar. Më pas departamenti informon pedagogët në lidhje me rezultatin e vlerësimit. https://bit-albania.com ; http://upt.al/cilesia-ne-upt. Një analizë përmbledhëse e pyetësorëve në nivel Universiteti bëhet edhe në mbledhjen e radhës së Senatit Akademik. [Ref_122]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se IAL ka si parim vlerësimin dhe promovimin e praktikave të mira në mësimdhënie përmes mjeteve të tij të komunikimit siç janë e-mail, platformat e komunikimit dhe mësimin on-line Microsoft, Teams etj. Analiza e pyetësorëve, si në nivel Universiteti, ashtu edhe njësie bazë, ka për qëllim promovimin e praktikave më të mira, nxitjen e vazhdimësisë së tyre, dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. [Ref_014; 028; 125]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies</p>	<p>Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimin dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma harmonizohen midis tyre përmes</p>

<p>dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>raporteve të caktuara, të parashikuara në planet mësimore, në programet e lëndëve dhe në rregulloren mësimore të programit të studimit. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transferimit të dijeve e njohurive të përfshira PS Bachelor në Inxhinieri Elektrike janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat (ushtrime, detyra e kursit dhe projektet), dhe praktikat profesionale etj. Për programin mësimor institucioni ka organizuar, leksione të hapura dhe vizita në institucione. Vizitat janë kryher pranë qendrave industriale të cilat kanë të integruara sisteme elektrike energjitike si Teci Vlore, Impianti fotovoltaiq Fier dhe Hidrocentrali Ashte, Fierze etj. Këto forma mësimdhënie janë të miratuara nga institucioni dhe pasqyrohen në rregulloren e programit të studimit. [Ref_018; 037; 088]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Nga vizita në institucion u verifikua se stafi pedagogjik i përgjigjet me seriozitet diversitetit dhe nevojave të studentëve. Pedagogët në përputhje me natyrën e programit ofrojnë metoda dhe mundësi alternative (shëmbuj realë, etj) në mënyrë që studenti të rrisë interesin dhe dëshirën e të nxënit. Përdorimi i sistemeve kompjuterike është me vlerë në mbarëvajtjen e mësimdhënies. Gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët, u sollën shembuj të ofrimit nga ana e pedagogëve të metodave të ndryshme për ta bërë lëndën sa më të kuptueshme dhe të qartë për studentin. [Ref_018; 124].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se institucioni mbështet përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible për zhvillimin e mësimdhënies me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e rezultateve të të nxënit. Institucioni ka investuar në përmirësimin e metodave dhe kushteve të mësimdhënies. Çdo fillim viti akademik NJSBC, organizon trajnime për stafin akademik, është organizuar një trajnim në nivel Fakulteti për nxitjen e përdorimit të platformës Google Classroom dhe Teams. Institucioni gjithashtu, përmes postës elektronike ofron mundësinë e përdorimit të platformës Office 365 edhe ajo e vlefshme në kuadër të edukimit online. Gjatë viteve të fundit i është kushtuar një vëmendje të veçantë edhe kualifikimit të stafit akademik duke e mbështetur financiarisht me pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe botime në revista të ndryshme. UPT ka mbështetur vazhdimisht personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, kjo dëshkohet edhe nga marrëveshjet e shumta të bashkpunimit me institucionet homologe jashtë dhe brenda vendit të nënshkruara. [Ref_019; 020].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit (dosjeve të personelit akademik), themi se personeli akademik është kompetent për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Ai është i kualifikuar sipas profilit të lëndës që zhvillon, i përket kategorisë profesor, doktor dhe Msc., si dhe me një angazhim të konsiderueshëm në punën kërkimore shkencore. Personeli akademik zoteron eksperiencë dhe kualifikime të shumta, përdor metoda të ndryshme (metoda kompjuterike, metoda klasike,</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 28


	simulime, etj) për shpjegimin e tematikave të profilit. [Ref_017; 128; 129].			
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga vizita në institucion rezultoj se format dhe metodat e mësimdhënies janë në vlerësim të vazhdueshëm nga vetë stafi akademik dhe departamenti që mbulon programin mësimor në fjalë. Koordinator i programit të studimit është në komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe vemendje e veçantë ju kushtohet sugjerimeve që vinë nga vetë studentët, me qëllim rritjen e nivelit të mësimnxënies dhe përmirësimin e rezultateve përfundimtare të studentëve sidomos pas rezultateve të siguruar nga NJSCB. Mënyra e vlerësimit të formave dhe të metodave të mësimdhënies nga studentët fillon direkt në klasë duke diskutuar me ta në lidhje me elementë të veçantë të paraqitjes së tij dhe të përmirësimeve eventuale për metodat e mësimdhënies. Gjithashtu në fund të çdo viti akademik stafi akademik efektiv bën raportin e punës së tij mësimore ku analizon ndër të tjera format e mësimdhënies dhe prezanton përmirësimet e mundëshme. [Ref_014;037; 070; 071]			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Nga biseda me personelin akademik dhe me studentët u verifikua se gjatë orëve të seminarëve dhe leksioneve vihen në përdorim një numër i madh shembujsh reale në mënyrë që ora mësimore të bëhet sa më tërheqëse dhe të nxitet diskutimi në lidhje me tematikën në fjalë. Në programet lëndore, çdo pedagog vazhdimisht përmirëson dhe pasuron me tematika të ndryshme që realizohen në laboratorë duke rritur interesin e studentëve. Përdorimi i rasteve studimore ndihmon në rritjen e interesit të studentëve në procesin mësimor dhe në rritjen e nivelit të aplikueshmërisë së informacioneve të marra në praktikë. Këto rezultate duken dhe në raportet e anketimeve të studentëve. [Ref_018; 071].			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Një nga format kryesore të inkurajimit të autonomisë së studentëve dhe punës në grup janë detyrat e kursit, projektet e kursit, praktikat e zhvilluara prej tyre në ndërmartje si dhe prezantimet që ata përgatisin si pjesë e këtyre detyrimeve Metodat e përdorura në mësimdhënie nxisin autonominë e studentit, i cili fillimisht punon nën mbikëqyrjen e pedagogut dhe më pas fillon të punojë në mënyrë graduale si i pavarur, është në gjendje të zgjidhë vete problemet e ndryshme inxhinierike të fushës. Nga biseda me personelin akademik u sollën shembuj të punimeve të kryera nga studentët nën mbikëqyrjen e pedagogut, të cilat janë referuar në konferencat shkencore studentore.[Ref_082; 124].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike zhvillon aktivitetin, duke përdorur në mënyrë të përbashkët me dy njësi të tjera kryesore dhe me Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dy godina, godinën e Korpusit Qendror të UPT dhe godinën e Shtesës së Korpusit Qendror të UPT . Objektet kanë akustikë të mirë dhe izolimi nga zhurmat është brenda standardeve (godina e Shtesës së Korpusit Qendror është ndërtuar e re, ndërsa shtesa anësore e objektit Korpusi Qendror, në të cilën zhvillon aktivitetin FIE, i është nënshtruar rikonstruksionit). Nga dokumentacioni i shqyrtuar si dhe nga vizita në ambientet e institucionit, rezulton se FIE në këtë godinë shfrytëzon sipërfaqen prej 5382.5 m². Ambientet në përdorim nga FIE në këtë godinë janë si në vijim. Sallat e leksionesh janë 5 (pesë), me një sipërfaqe totale e tyre është 1150 (nje mijë e njeqin e pesëdhjetë) m². Janë gjithsej 9 salla seminaresh me sipërfaqe totale 452.7 m². Ambientet laboratorikë janë në harmoni me specifikat e moduleve lëndore. Fakulteti zotëron 11 (njëmbëdhjetë) laboratorë për lëndët dhe një laborator informatike, në total 676.58 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë, pikë pesëdhjetë e tetë) m² në këtë godinë. Ambientet e stafit përbëjnë: zyrën e Dekanit, dy zyrat e zv.Dekaneve, zyrën për Administratorin, zyrën për sekretarinë mësimore, 12 zyra për personelin akademic, zyrën e financës, ambiente për koordinimin dhe mbështjen e studentëve. Sipërfaqja totale në përdorim nga FIE në të dy godinat, duke marrë parasysh sipërfaqet në përdorim dhe pjesën proporcionale të sipërfaqeve të përbashkëta është 5971.8 m². Numri i studentëve aktivë për vitin akademik 2021 – 2022 është 671 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e një). Numri aktual i të punësuarve personel akademik me kohë të plotë është 33 (tridhjetë e tre), ndërsa numri i të punësuarve personel akademik me kohë të pjesshme është 11 (njëmbëdhjetë). [Ref_017; 046; 132].</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Nga sa më sipër GVJ konkludon se një pjesë e godinës qendrore të UPT ku zhvillon aktivitetin FIE i është nënshtruar një rikonstruksion tërësor dhe pas tij auditorët mësimorë janë paisur tërësisht me mobilime të reja (ndricimi, tavolina, karrike, tabela, etj.). Po ashtu në pjesën tjetër të godinës qendrore (kulla qendrore e korpusit) ambientet janë të paisura me gjithë logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor në mënyrë cilësore. Auditorët e leksioneve janë paisur me videoprojektor fiks, ndërsa një pjesë e pedagogëve shfrytëzojnë videoprojektorët dhe laptopët e lëvizshëm të departamenteve të FIE, për përdorim në sallën e mësimorit. Për zhvillimin e pjesës laboratorike të lëndëve të ndryshme shfrytëzohen laboratorët përkatës të departamenteve të FIE. Gjithashtu studentët e PS Bachelor në Inxhinieri Elektrike profili energjitikë për lëndët që mbulohen nga fakultetet e tjera të UPT (Fizika, Kimia, Informatika, Gjuha e Huaj, Bazat e Elektroteknikës, etj.) shfrytëzojnë laboratorët përkatës të këtyre fakulteteve.</p> <p><i>GVJ sugjeron nxitjen sa më shpejtë të projektit për mundësinë e shfrytëzimit të kateve të sipërme të godinës qendrore të UPT për studentët dhe personat me aftësi të kufizuara.</i></p> <p>[Ref_051; 132].</p>

<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoj se godina ku zhvillohet procesi mësimor i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë është ngritur një rrjet kompjuterik, në funksion të procesit mësimor dhe atij shkencor i cili siguron lidhje fizike (kabllore) në çdo sallë mësimore dhe në zyrat e personelit. Lidhja me Internetin është dubluar me dy lidhje të pavarura, ajo është cilësore dhe mundëson lehtësi të aksesimit e platformave të ndryshme. Në FIE është në përdorim edhe rrjeti wireless, i cili mundëson lidhje cilësore dhe të sigurtë në të gjitha ambientet për stafin akademik. FIE prej disa vitesh u mundëson studentëve dhe stafit të tij përdorimin e plotë të platformës Office 365, kjo platformë u lejon përdorimin e mbi 26 moduleve të ndryshme si: Email, Teams, Onedrive, Forms, modulet e tjera të përfshira në paketën “Microsoft Office 365” përdoren me sukses për shkëmbim dhe përpunim informacioni dhe raportesh me dhe për studentët. Studentët e pedagogët mund të komunikojnë edhe përmes adresave zyrtare të tyre që FIE ka konfiguruar në formën emër.mbiemër@fie.edu.al</p> <p>Në dispozicion të studentëve të PS Bachelor në Inxhinieri Elektrike janë edhe laboratorët e: Kompjuterave (në FIE), Gjuhëve të Huaja (në Godinë qendrore të UPT), Informatikës (në FTI), etj. Gjithashtu në funksion të lëndëve të ndryshme një pjesë e laboratorëve të FIE janë paisur dhe me software për simulime kompjuterike [Ref_051; 124].</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga verifikimi në institucion mund të themi se ciklet e leksioneve për programin e studimit Bachelor “Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë jepen në formën e mëposhtëme: Leksione të shkruara, në power point dhe në literaturë, formë dispence (libri). Materialet didaktike për mbarëvajtjen e procesit mësimor gjenden edhe në bibliotekën e fakultetit, e cila qëndron e hapur (nga e hëna deri të shtunë) në oraret e përshtatshme për studentët. Literatura bazë e çdo lënde gjendet në bibliotekën e FIE, Qendra Multimediale ose në Bibliotekën Shkencore të UPT, të cilat janë të aksesueshme nga studentët e FIE. Literatura bazë zgjidhet të jetë lehtësisht e lexueshme nga studentët ajo është autorëve me të spikatur të fushave përkatëse. Literatura ndihmëse ajo sigurohet edhe në formë elektronike nëpërmjet lidhjes së bibliotekave të UPT me rrjetin e katalogimit. Biblioteka digjitale mundëson akses në një bazë të dhënash me mbi 193 mijë libra akademikë, mbi 50 mijë revista shkencore, mbi 200 milion lajme shkencore si dhe 30 paketa për mësimin e gjuhëve të huaj. Në dispozicion të studentëve, është edhe libraria digjitale. [https://ulibrary.rash.al/] dhe [COBISS: [https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries]]. Kjo ka siguruar që të gjitha literaturat e rekomanduara nga titullarët e lëndëve të gjenden lehtësisht në formë fizike apo online. [Ref_018; 049; 124]</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për</p>	<p>Biblioteka Shkencore e Universitetit Politeknik është institucion kulturor dhe informues dhe e ushtron veprimtarinë e vet në shërbim të procesit mësimor, edukativ, të formimit profesional dhe të veprimtarisë shkencore të Universitetit Politeknik të Tiranës.</p> <p>https://biblioteka-shkencore.edu.al dhe http://www.fie.upt.al/biblioteka.php.</p>

<p>përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka mbështet studentët dhe stafin akademik në punën shkencore përmes sigurimit të informacionit në fushat e interesit të tyre. Shërbimet teknike, si pasurimi me literaturë të re dhe përpunimi standard i tyre, kryhen respektivisht nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve dhe Sektori i Katalogimit, pranë BSHQ. Nga vizita në institucion u vërejt se ambientet e bibliotekave janë komode, me hapësirë, dritë dhe shërbim nga personel ndihmës akademik i dedikuar. Koefiçenti i shfrytëzimit të ambientit të bibliotekës së FIE llogaritet rreth 67%.Kjo bibliotekë vë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve 65570 tituj dhe 75 vende leximi. [Ref_024; 049; 050].</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në bibliotekë mësuam se në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, prej vitit 2019 është realizuar katalogimi dhe kërkimi në bibliotekën qendrore të UPT-së, COBISS që është funksionale dhe ofrohen edhe shërbimin e bibliotekës digjitale. [https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries] ; [https://ulibrary.rash.al/]. Biblioteka digjitale mundëson qasje në një bazë të dhënash me mbi 193 mijë libra akademikë, mbi 50 mijë revista shkencore, mbi 200 milion lajme shkencore si dhe 30 paketa për mësimin e gjuhëve të huaj. Përmes COBISS, studentët mund të lidhen online edhe me 15 biblioteka universitare, 10 biblioteka publike dhe 3 biblioteka speciale në 11 qytete të Shqipërisë. Studentët do të kenë mundësi të aksesojnë literaturë ndihmëse që do ti ndihmojë në thellimin e njohurive në përgjithësi dhe në këtë program studimi në veçanti, si dhe në zhvillimin e temave të diplomave. Kjo literaturë synon të jetë bashkëkohore dhe të përmbajë tituj më me zë të fushave që ndërthuren në programin e studimit në Inxhinieri Elektrike. [Ref_049].</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se për këtë program studimi në lëndët bazë, ndërdisiplinore, specifike dhe ato karakterizuese, infrastruktura laboratorike ishte e mjaftueshme. Për realizimin e një pjesë të komponentëve mësimorë (laboratore, detyra kursi, etj.) studentët e PS Bachelor në Inxhinieri Elektrike në varësi të lëndës shfrytëzojnë gjithë bazën laboratorike që disponon FIE. Ndërsa për realizimin e këtyre komponentëve për lëndët (Kimi, Fizikë, Informatikë, Gjuhë e Huaj, Elektroteknikë, etj.) që mbulohen nga stafi akademik jashtë FIE shfrytëzohen labororet e fakulteteve përkatës. Gjithashtu për realizimin e projekt diplomave student në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës ka të drejtë të shfrytëzojë labororet përkatës të FIE. [Ref_008; 051].</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Nga biseda me stafin akademik verifikuam se FIE ka marrëveshje me kompaninë Microsoft, në këtë kuadër studentët dhe stafi sigurojnë falas qasjen në platformën Office 365, pjesë e platformës janë edhe modulet e mësimin on-line (e-learning) si Teams. Për të lehtësuar qasjen e stafit dhe studentëve me këto platforma, në dispozicion të stafit akademik të FIE ka manuale trajnimi në formë të shkruar dhe video. Në funksion të mësimdhënies është edhe Platforma bit-albania e cila i është dedikuar kryesisht menaxhimit të sekretarisë mësimore, kurrikulave, etj. Që në momentin e regjistrimit studenti pajiset me username dhe password për llogarinë e tij. [https://bit-albania.com/upt6.php],</p>

	Gjithashtu gjatë kohës së karantinës pedagogë dhe studentë të FIE kanë përdorur platforma të tjera online për zhvillimin e procesit mësimor Google Classroom, Google meeting, Zoom, etj. Për të lehtësuar qasjen e stafit dhe studentëve me këto platforma, në dispozicion të stafit akademik të FIE ka manuale trajnimi në formë të shkruar dhe video. [Ref_085; 124].			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Personeli akademik i FIE-së si dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm si: nëpërmjet platformës bit-alnania, Microsoft Teams, emailit zyrtar, ndër të tjera edhe për të patur akses në dokumentacionin elektronik (leksione, formularë, fatura, etj). (emër.mbiemër@fie.edu.al). Aksesit në këtë dokumentacion bëhet nëpërmjet përdorimit të hapësirës vetjake të dedikuar për secilin përdorues të FIE ose përdorimit të adresës elektronike personale zyrtare.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Mbështetur në planin mësimor të programit të studimit dhe rregulloren e Brendshme e DSEF përcaktohet se “Studentet në programet e ciklit të parë të studimeve, diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar”. Njësia bazë është përgjegjës për përgatitjen e provimit përfundimtar. Gjithashtu FIE ka hartuar dhe miratuar “Procedurën e konceptimit dhe mbrojtjes së provimit të përgjithshëm të ciklit të parë bachelor në FIE”. Njësia bazë e programit të diplomës ka përgjegjësinë e drejtimit të punës për realizimin e punës praktike, aplikative si edhe për orientimin e studentit diplomant në shfrytëzimin e literaturës relevante. Njësia bazë përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentet, përgjatë të cilave konsultohet me pedagogët e lëndëve, sipas programit të miratuar. [Ref_009; 070; 074; 084]. <i>GVJ rekomandon Departamentin të parashikojë në rregullore dhe të nxisë e mbështesë studentët e vitit të tretë me rezultate të larta (me mesatare mbi 9.0), për mbylljen e studimeve me temë diplome, duke mbështetur kështu edhe përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies UPT e ka bazuar në ngritjen e strukturave përkatëse si Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të cilat janë përgjegjëse për respektimin e standardeve të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve si dhe të gjithë dokumentacionit të programeve të studimit, si dhe në përmirësimin e cilësisë së stafit akademik, përmirësimin e infrastrukturës laboratorike e të mësimdhënies dhe përsosjen e metodave të mësimdhënies, elementë të cilët i nënshtrohen një vlerësimi periodik nga njësitë bazë dhe studentët. [Ref_002]. [http://upt.al/cilesia-ne-upt] dhe Drejtorinë e Kurrikulave [http://upt.al/dega-mesimore],

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti Sistemeve Elektrike të Fuqisë, Departamenti i Automatizimit të Industrisë, Departamenti i Elektroteknikës, si dhe në përputhje me strategjinë e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, programi i ciklit të parë të Studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitike organizohet dhe menaxhohet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS), i cili përbëhet nga 5 anëtarë. Anëtarët e KPS propozohen nga departamentet që bashkëpunojnë për këtë program studimi dhe miratohen në Dekanatin e FIE. Çdo fund viti akademik stafi akademik harton raportet e punës mësimore të cilat i përcillen drejtuesit të departamentit. Ky i fundit në bazë të këtyre raporteve harton raportin e analizës mësimore të departamentit ku përfshihen dhe programet e studimit që mbulon departamenti. Zv. Dekani për mësimin më tej harton raportin e analizës mësimore të fakultetit. [Ref_008; 011; 016; 037].</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe verifikimi i dokumentacionit u verifikua se IAL përmes strukturave përkatëse mbështet përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në funksion të përmbushjes së objektivave të të mësuarit. Për këtë FIE ka mundësuar shërbimet online të mësimdhënies dhe ka organizuar trajnime të personelit akademik mbi mënyrat e përdorimit të tyre.</p> <p>Metoda inovative të mësimdhënies kanë ndihmuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies, komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni, ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Një shembull i mirë në këtë rast janë diskutimet aktive me përfaqësues të kompanive, të cilët kanë bërë prezantime të ndryshme të fushave dhe teknologjive të reja.</p> <p>UPT zhvillon dhe zbaton mekanizma për promovimin dhe zotërimin e një kulture të cilësisë në të gjitha njësitë dhe të gjitha nivelet, zhvillimin e procedurave për monitorimin dhe rishikimin e cilësisë akademike, rritjen e cilësisë në qeverisje dhe menaxhimin e institucionit, me synim rritjen e cilësisë në të gjitha programet e studimit që ofron. [Ref_010]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik i FIE i angazhuar në mbulimin e lëndëve të planit mësimor të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, kualifikohet në mënyra të vazhdueshme sipas fushave të kërkimit shkencor individual [Ref_017], Tabelat 1-24. Ky proces aktualisht është bërë falë edhe suportit të institucionit, i cili ka mbështetur financiarisht dhe jo vetëm në pjesmarrjen e stafit në projekte, seminare, trajnime, workshop-e, konferenca shkencore, etj. Nga FIE është organizuar Konferencë ndërkombëtare “Energjitë e Rinovueshme dhe Teknologjitë Smart”. Në kontekstin e kërkimit shkencor stafi i FIE ka arritje të mira. Kjo gjë pasqyrohet në gradat shkencore e titujt akademikë që ata kanë marrë si dhe në botimet e shumta shkencore që ata kanë bërë, një pjesë e të cilave të botuara në revista shkencore më faktor impakti [Ref_015]. Të dhëna të plota të aktiviteteve për kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit janë gjithashtu në CV e tyre [Ref_129]. Ky kualifikim i personelit akademik të FIE ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se në fillim vitit akademik, zyra e</p>

<p>përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>“NJSC ALUMNI dhe Karrierës”, në bashkëpunim me drejtuesit e departamenteve organizon trajnime për stafin akademik, kryesisht me stafin e ri ose të rekrutuar. Trajnimi ka për qëllim përmirësimin e aftësive mësimdhënëse dhe mbi metodat didaktike që përdoren. Mbështetja e institucionit për stafin në pjesëmarrje në projektet kërkimore, e në mënyrë të veçantë në mobilitetet e mundësuar prej projekteve ERASMUS+, është një mënyrë shumë e mirë për stafin akademik (përfshirë këtu edhe stafin e FIE), për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të tjera. [Ref_027; 028].</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se stafi akademik dhe ai ndihmës akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë është i interesuar dhe angazhuar, për implementimin sa më të sukseshëm të programit të studimit bachelor dhe për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Kjo është gjithashtu një detyrim që rrjedh nga zbatimi i detyrimeve të tyre ndaj rregulloreve përkatëse të FIE Një ndihmë për përmirësimin e aftësive të tyre dhe implementimin e metodave të reja janë dhe trajnimet e tyre në Universitetet të huaja perëndimore. Sipas stafit qëllimi kryesor përkon me nxitjen e mësimnxënies tek studentët dhe përgatitjen e tyre sipas kërkesave të tregut të punës. Në këtë kuadër, stafit akademik dhe ndihmës akademik njihet me metodat më të fundit të mësimdhënies. Departamenti, gjatë mbledhjeve të përmuajshme, diskuton mbi këto metoda. [Ref_008]</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoj se stafi akademik dhe ai ndihmës akademik përgjegjës për programin e studimit u lejonet të testojnë metoda të reja në mësimdhënie. Në mbledhjet e departamentit bëhet një analizë mbi metodat e implementuara si dhe për rezultatet e përfuara prej tyre. Një tregues i qartë për këto metoda është përdorimi i platformave e-learning gjatë dhe pas periudhës së COVID-19. Gjithashtu departamenti i kushton kujdes të veçantë nivelit të studentëve që regjistrohen në vitin e parë, për këtë anëtarët e KPS-së së programit të studimit mbledhin opinionet e studentëve me qëllim të trajtimit të temave të munguara, kryesisht me studentët e vitit të parë në lëndët e matematikës dhe fizikës. [Ref_014; 032]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të</p>	<p>Kriteret e vlerësimit të studentëve janë të paraqitura në rregulloren e IAL. Megjithatë në syllabusin e lëndëve është dhënë dhe metoda e vlerësimit të studentit. Metoda e vlerësimit është publike dhe studenti është i njohur me të.</p>

posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.

[Ref_037; 074]. (<https://www.upt.al/2014-11-05-10-00-43>).

Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.

Nga vizita në institucion rezultoi se në fillimi të çdo viti akademik studentët informohen në lidhje me metodologjinë e testimit dhe vlerësimin e njohurive dhe dijeve. Ato janë të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve në javën e parë të procesit mësimor. Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:

- Provimit përfundimtar.
- Provimi i ndërmjetëm.
- Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, punë laboratorike, detyra/projekte kursi.

Nga studimi i Syllabuseve për çdo lëndë, verhet se ka dispropocione të theksuara në “peshën” e pikëzimit në përcaktimin e notes përfundimtare. Provimi i ndërmjetëm zhvillohet nga pedagogët jashtë mbikqyrjes së departamentit.

GJV rekomandon që të rishikohet vlerësimi i vazhduar i studentit duke unifikuar metodologjinë e vlerësimit dhe kontrollit të njohurive me pikëzim për të gjithë rubrikat, nga provimi i ndërmjetëm/moduli, laboratorit, pjesëmarrja dhe aktivizimi në seminar, detyra kursi/projekte dhe provimim përfundimtar. Gjithcka të jetë e evidentuar në proces verbalin paraprak i cili mbas çdo vlerësimi të jetë i depozituar në sekretarinë mësimore dhe të shoqërojë procesverbalin përfundimtar.

Kontrolli i vazhdueshëm (Model për referencë)

Pjesëmarrje dhe aktivizimi në orët e seminareve dhe ushtrimeve	5 %
Dorëzim i detyrës së kursit	5 %
Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë	10 %
Provimi i ndërmjetëm/Moduli	20 %
Provimi përfundimtar	60 %
Gjithsej	100 %

PROCESVERBALI I NOTAVE

Nr.	Emri	Mbiemri	Moduli	Vlerësime të tjera		Pikë Detyre	Tot.	Pikët e provimit	Pikët Tot.	Nota
				Laborator	Seminar					

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

Studentët njihen me format e vlerësimit që në orët e para të mësimit Kjo mundësohet nga ana e pedagogut të lëndës, gjatë njohjes së studentit me përmbajtjen e programit të lëndës.

Dija e studentit kontrollohet në çdo rast nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm të pedagogut me studentin në formën e bashkëbisedimit, nëpërmjet zhvillimit të testeve ose seancave të kontrollit të dijes.

Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore dhe format e kontrollit përfundimtar në vlerësim të laboratoreve dhe vlerësimit të projektit, detyrave të kursit në disa lëndë

	<i>vleresohej në formë taksative “Fiton”, “Nuk fiton”.</i> <i>GVJ rekomandon që të rishikohet vlerësimi me pikezim dhe gjithcka të jetë e evidentuar në proces verbalin paraprak i cili mbas çdo vlerësimi të jetë në sekretarinë mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Pas vizitës në institucion, takimit me stafin dhe studentët, GVJ konkludon se kontrolli i dijes në një lëndë bëhet në mënyrë të vazhdueshme, i shtrirë përgjatë kohës së zhvillimit të lëndës. Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga pedagogu/pedagogët në programin e modulit/lëndës dhe miratohet para fillimit të çdo viti akademik nga Drejtuesi i Departamentit. Format kryesore të kontrollit të vazhduar për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të lëndës janë: detyrat e kursit, projektet e kursit, testimet e ndërmjetme dhe shlyerja e laboratoreve. Vërehet një mungesë unifikimi në mënyrën e vlerësimit për lëndë me tipologji të ngjashme. Siç u theksua edhe më sipër mungesa e një procesverbali analitik, vështirëson transparencën lidhur me pikët e fituara gjatë vitit akademik. Provimi final, sipas përcaktimeve në syllabus, organizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Studenti ka të drejtën e hyrjes në provim kur plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloret e studimeve dhe procedurës për vlerësimin e dijeve, dhe i nënshtrohet provimit final. [Ref_018; 037].
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminonin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga vizita në institucion rezultoi se format e testimit janë ato klasike. Kontrolli i dijes bëhet me shkrim, me gojë me detyra kursi, me projekte kursi ose me shkrim dhe me gojë, si në rastin e provimeve, ashtu dhe në testimet apo seancat e kontrollit që mund të organizohen gjatë semestrit ose gjatë vitit. Nota i komunikohet studentit në mënyrë individuale. Aktualisht, në UPT, nuk ka në zbatim një sistem elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve avantazhet e të cilit do të rrisnin transparencën dhe mundësonin reduktimin në maksimum të abuzimit dhe subjektivitetit në vlerësimin e studentëve. Në platformën elektronike <i>bit-albania</i> hidhen rezultatet dhe për elementët e vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit përfundimtar, duke informuar studentët në kohë reale për rezultatet e tyre dhe duke rritur transparencën. [Ref_085 Aksesi në sekretarinë online nga studentët]
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre	Nga vizita në institucion rezultoj se gjatë zhvillimit të provimit në sallë janë prezentë 2 pedagogë (monitorues). Pedagogët janë përgjegjës për zbatimin e rregullave të miratuara për procesin e zhvillimit të provimit dhe për çdo vendimarrje që lidhet me mbarëvajtjen e këtij procesi. Për çdo vendimarrje të kësaj natyre ata venë në dijeni menjëherë

është titullari i lëndës/modulit.	përgjegjësin e departamentit. Pedagogët monitorues janë lektori i lëndës dhe asistent – lektori i lëndës ose pedagog i grupit përkatës. Në rastet kur nuk ka një të tillë, departamenti vendos një pedagog tjetër me profil të afërt me lëndën e provimit. [Ref_037; 044]
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Në Rregulloren e programit të studimit dhe nga vizita në institucion rezultoi se zhvillimi i provimeve me shkrim zgjasin 2-4 orë dhe realizohet në kushtet e anonimitetit, përmes sekretimit të provimeve. Përgjegjës për sekretimin është sekretaria mësimore. Pas korrigjimit, provimet depozitohen pranë departamentit ku bëhet ç'sekretimi tyre. Vlerësimi i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës. Në tezën e provimit përveç vlerësimit janë dhe firmat e pedagogut apo pedagogëve që e kanë marrë pjesë në korrigjimin e saj. [Ref_044]
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pedagogët u japin studentëve këshilla në lidhje me lëndën mësimore. Studentët konsultohet vazhdimisht me pedagogun përgjegjës së lëndës mësimore, sidomos në vlerësimin e bërë përgjatë zhvillimit të lëndës, në laboratorë, detyra/ projekte, kontrole të ndërmjetme, etj. Nëpërmjet diskutimit ata marrin këshillat e nevojshme të cilat u shërbejnë për përmirësimin e të nxënësve. Kjo u theksua edhe nga studentet gjatë takimit që u realizua me ata.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i listave të notave u la të kuptohet që pedagogët përpunonin të shmangin në maksimum fenomenin e kopjimit në provime. (Duke realizuar teza të ndryshme dhe ndarë studentët në grupe të ndryshme, duke rritur distancën e sigurisë midis studentëve në provim, etj). Studenti, i cili në provim përdor forma e mjete të palejueshme, përjashtohet nga provimi. Komisioni i provimit vë në dijeni drejtuesin e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, për të proceduar më tej në përputhje me Kodin e Etikës së UPT-së. Këto rregulla janë të shprehura në Rregulloren e programit të studimit [Ref_006; 037]
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i provimeve të korrigjuara u verifikua se: Korrigjimi i provimit për lëndën mësimore bëhet nga pedagogu titullar. Korrigjimi mundësohet brenda 5 ditë pune nga dita e përfundimit të provimit sipas Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. Në rastet e provimeve të zhvilluara online (Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19) ku një pjesë e tyre realizohet me alternativa apo forma të kombinuara me zhvillim, studenti merr përgjigjen korrekte për çdo pyetje dhe komentet e pedagogut për vlerësimin e secilës pyetje, në sistemin Teams, ku është vendosur provimi i realizuar në assignment.
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët u verifikua se, studenti njihet me tezën e provimit pas korrigjimit. Studenti njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë ta reklamojë provimin me anë të një kërkesë me shkrim. Studenti e depoziton kërkesën pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit. Studenti merr përgjigje brenda një

	afati prej 3 ditë pune nga shpallja e rezultatit. Këto rregulla janë të shprehura në Rregulloren e programit të studimit dhe në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT. [Ref_037, Neni 34, pika 10].			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Nga vizita në institucion u verifikua se: Në rast se studenti depoziton në sekretarinë e dekanit kërkesën për rishqyrtimin e provimit, dekani mund të thërrasë për sqarime drejtuesin e njësisë bazë përkatëse, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë, brenda tri ditëve pune. Në rast se ankesa është e drejtë, dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit, për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të rivlerësohet ose të rijapë provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë, dokumentohet. [Ref_037, Neni 35, pika3].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, program i studimit ka objektiva të caktuara për formimin e studentëve, të cilat përbëhen nga bashkësia e dijeve, aftësimeve e kompetencave profesionale, që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin kulturor e profesional të këtij programi. Programi i ciklit të parë të studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike me profil Energjitikë” në thelbin e tij ka si objektiv kryesor t’u japë studentëve njohuri shkencore themelore në fushën e inxhinierisë dhe më specifike në atë të Inxhinierisë Elektrike. Programi ofron njohuritë bazë të moduleve të shkencave natyrore, elektrike, informatike, mekanike dhe elektronike. Ato kanë një lidhje organike midis tyre në funksion të asaj që synojmë të arrijmë në nivelin bachelor, njohuri bazë dhe profesionale. [Ref_018; 074]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Për të garantuar zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit në kurrikulën e PS Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitike, programi përmban lëndë të tilla si: Bazat e Informatikës, Gjuhë e Huaj, CAD (Vizatim me Ndihmën e Kompjuterit), Ekonomi dhe menaxhimi i ndërmarrjeve, etj. Këto lëndë i japin mundësi studentit të kuptojnë tregun e punës, të jetë më komunikues, të jetë i aftë të punojë në grup, të jetë i aftë në fushën e teknologjisë dhe informacionit, të ketë një bazë solide të terminologjisë teknike në gjuhën angleze si dhe aftësi që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës. [Ref_018; 074].
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të	Pedagogët përgjegjës për programin e studimit verifikojnë kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në përfundim të lëndës mësimore. Kjo

<p>paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>mundëshohet nëpërmjet kontrollit të detyrave të kursit, punëve të laboratorit të cilat dorëzohen nga studentët gjatë orëve të fundit të mësimit. Në lëndë të veçanta pedagogët realizojnë dhe teste të pjesëshme. Në fund të çdo semestri, stafi akademik harton raportin semestral, në të cilin raporton për realizimin e objektivave të mësimdhënies. [Ref_014; 032]</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion u verifikua se: në përfundim të çdo lënde stafi akademik përgjegjës orienton studentët drejt pikave dhe çështjeve më të rëndësishme. Këto pika mund të jenë subjekt i provimit si dhe janë elementë të rëndësishëm të cilët gjejnë përdorim në aplikime reale industriale. Gjithashtu, me kërkesë të studentëve pedagogu i lëndës zhvillon seanca konsultimesh përpara zhvillimit të provimit.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në varësi të zhvillimeve të reja të shkencës së inxhinierisë elektrike si dhe teknologjive inovative në këtë fushë, jashtë strukturës së programit të studimit janë organizuar nga personeli akademik i brendshëm orë të hapura dhe seminare, si psh: Prof. Dr. Marialis Celso, Prof. Nako Hobdari, Prof. Raimonda Buhajoti. Gjithashtu përmes ftesës së profesorëve të huaj është bërë e mundur organizimi i seminareve dhe trajnimeve të hapura për studentët [Ref_022 Personel Akademik i huaj i ftuar]. Gjithashtu në FIE është bërë tashmë një praktikë e mirë organizimi i Workshop-ve Studentore, ku studentët nën drejtimin e pedagogëve bëjnë referime të ndryshme rreth zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë [Ref_076].</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga takimi i organizuar me pedagogët dhe ai me studentet evidentuam se puna mësimore me studentët përfshinte një larmi formash të mësimit dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma harmonizohen midis tyre përmes raporteve të caktuara, të parashikuara në planet mësimore, në programet e lëndëve dhe në rregulloren mësimore të programit të studimit [Ref_037, 25]. Në UPT format kryesore të punës mësimore ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ format e mësimit teorik e praktik, ku përfshihen: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, studiot, projekt – diplomat, etj.; ➤ format e kontrollit të dijeve, ku përfshihen: bashkëbisedimet, mbrojtje e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e lëndës, provimet e formimit, mbrojtje e temave e diplomave, etj. <p>Mësimdhënia me lëndët e planit mësimor për programin e studimit të ciklit të parë “ Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjetike ”, realizohet prej stafit akademik mbi bazë kompetencash, në mënyrë të veçantë për lëndët të cilat u japin studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë. Studentët duhet të testohen t’i aplikojnë këto kompetenca në laboratorë kompjuterikë (si p.sh. për lëndët Informatikë, Kimi, CAD, etj). Studentët materializojnë dijet e fituara në detyra apo projekt kurs, ku qëllimi është testimi i kompetencave të</p>



Handwritten signature in blue ink.

	fituara [Ref_018].			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/ çështjeve të caktuara.	Nga vizita në institucion u verifikua se në disa tema dhe detyra kursi jepen në formë të tillë që të stimulojnë punën në grup. Sipas pedagogëve përgjegjës qëllimi kryesor është të nxitin e punën në grup aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve si dhe diskutimin e tyre. Kjo dëshmohet edhe në aktivizimin e studentëve në projekte dhe aktivitete shkencore.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nga vizita në institucion, në takimet me personelin akademik, studentët dhe drejtuesit i njësisë bazë e kryesore, rezulton se stafi akademik përgjegjës për programin e studimit mbështet implementimin e ideve inovative, gjatë detyrave të kursit, diplomave dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në konferenca studentore. Stafi është mjaft i motivuar edhe në zhvillimin e orëve të hapura ku pedagogë të ndryshëm me iniciativën e tyre shpesh kanë ftuar profesor të huaj, inxhinierë të spikatur të fushës së studimit. Bazuar në pajisjet laboratorike si dhe në stafin mësimdhënës studentët realizojnë eksperimente dhe punë inovative, nën mbikqyrjen e Në mënyrë të vazhdueshme FIE ka organizuar konferenca shkencore dhe konferenca shkencore të studentëve ku ata kanë marrë pjesë dhe janë paraqitur edhe me punime shkencore rezultat i bashkëpunimit të tyre me personelin akademik dhe mbështetjen që ata u kanë dhënë në këtë drejtim [Ref_076]			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga vizita në institucion u verifikua se: stafi akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë mbështet studentët për temat inovative. Për temat më interesante mundësohet dhe mbështetje financiare nga ana e institucionit. Mbështetja financiare nuk është në vlera të mëdha por është prezente. Në raste të tilla, produkti i mbetet universitetit. Kur studenti e vetëfinancon inovacionin e tij, atëherë ai është edhe zotëruesi i produktit. Gjithashtu FIE mbështet financiarisht përmes bursave studentët ekselentë ose dhe nëpërmjet që ju bëhet studentëve drejt aplikimeve të tyre në programet ERASMUS+, me universitetet që UPT ka marrëveshje të nënshkruara si me Greqinë, Italinë, Gjermaninë, etj [Ref_075; 076; 100; 101]			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nga vizita në institucion u verifikua se personeli akademik kombinon format e mësimdhënies me institucionet partnere për të mundësuar dhe rritur lëvizshmërinë e studentëve. FIE ka përdorur mundësitë e ofruara nga marrëveshjet e mobilitetit Erasmus+, që bëjnë të mundur vizita afatshkurtra dhe afatgjata të personelit akademik dhe studentëve. Në vitet e fundit në sajë të bashkëpunimeve me disa universitete në kuadër të projektit Gradua dhe marrëveshjes Erasmus+, një numër pedagogësh edhe studentësh kanë realizuar mobilitete dhe trajnime në disa universitete si në Krakow etj. Kjo rritje e mobilitetit të studentëve ka mundësuar tek ata një formim më të mirë profesional dhe për pasojë rritjen e mundësisë së punësimit të tyre. [Ref_019; 075]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Nga vizita në institucion u verifikua se, për zhvillimin e provimit final përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve të cilët diplomohen atë vit akademik, programin e provimit të formimit me anën e të cilave do të bëhet vlerësimi përfundimtar. Njohja me to mundësohet me fillimit të vitit akademik. Data e provimit përfundimtar caktohet 2 javë pas sezonit të provimeve. [Ref_074]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	<p>Pika 2 e nenit 16 e procedurës së Provimit të Formimit përcakton përgjegjësitë e sejcilës strukturë lidhur me realizimin sa më me sukses të këtij procesi të rëndësishëm [Ref_074]. Kështu:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Datat e zhvillimit të mbrojtjes sipas sesioneve përkatëse, propozohen nga drejtuesi i Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike. 2) Provimi i Formimit teston njohuritë që studenti ka marrë në lëndet profesionale. Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë harton programin e Provimit të Formimit. 3) Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat/ lëndët që përfshihen në programin e provimit sipas pesës specifike që kanë pyetjet e çdo fushe në tezën e provimit. 4) Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë harton fondin e pyetjeve një javë para fillimit të sesionit të provimit. 5) Fondi i pyetjeve duhet të jetë rreth 10 (dhjetë) herë më i madh se numri përkatës i pyetjeve që përmban teza në fushën përkatëse. <p>Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë harton oraret e konsultimeve për provimin e formimit në “Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë”.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe bashkëbisedimi me studentët u verifikua se, atyre ju vihet në dispozicion baza e të dhënave me pyetjet e provimit të formimit.</p>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe pesës specifike.	<p>Nga vizita në institucion si dhe nga biseda me pedagogët u verifikua se, teza e provimit përfundimtar hartohet si një përzgjedhje e pyetjeve nga baza e të dhënave të pyetjeve të provimit të formimit.</p> <p>Në fondin e pyetjeve të provimit të formimit përfshihen pyetje nga lëndët mësimore të zhvilluara gjatë tre viteve të studimit, por pesën specifike e përcaktojnë modulet teknike dhe specifike të programit të studimit. Në tezën e provimit përfundimtar jepen lëndët dhe pesha e tyre specifike. Teza e provimit përmban pyetje me alternative dhe me zhvillim. Provimi i formimit korrigjohet nga titullaret e lëndës dhe vlerësohet nga një komision i posaçëm, i cili propozohet nga Drejtuesi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani i FIE. Numri i anëtarëve të</p>

	komisionit të vlerësimit është jo me pak se 3 (tre). Komisioni i vlerësimit respekton, në çdo rast, për secilin student diplomant, procedurën dhe rregullat përkatëse, të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit dhe në këtë procedurë. Provimi organizohet me shkrim. Përgjigjet ruhen për një periudhë një vjeçare në arkiven e fakultetit.[Ref_070; 074; 084]
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Nga vizita në institucion si dhe nga biseda me pedagogët dhe studentët u verifikua se, stafi akademik i ndihmon këta të fundit gjatë periudhës së përgatitjes për provimin e formimit. Stafi akademik përgjegjës i ndihmon studentët me materialet e nevojshme mësimore, që do të shërbejnë gjatë zhvillimit të provimit. Në çdo vit akademik parashikohen tre sezona të provimit përfundimtar të formimit, pas sezonit të provimeve. [Ref_070;084]
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga vizita në institucion dhe bashkëbisedimi me studentët u verifikua se, institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorët e tij mjediset në biblioteka, salla kompjuterësh dhe shërbime të tjera, që FIE ofron për studentët, në mënyrë që ata të kryejnë punët eksperimentale për realizimin me sukses të temës së studimit. Stafi akademik dhe ndihmës akademik asiston dhe mbështet studentët për të realizuar testime dhe matje për kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit [Ref_008; 051]
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë, për të gjithë studentët që e ndjekin atë, përfundon me provimin final. [Ref_070]
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se studentit, në përfundim të provimit përfundimtar, është vlerësuar me notë. Nota është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Nota e vlerësimit është në përputhje me sistemin e vlerësimit që përdor IAL. Në rast se studentit vlerësohet me notë negative, ai mund të rihyjë në provim në sezonin e ardhshëm, pa tejkalluar afatin maksimal të përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi. [Ref_044]
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se studentët të cilët përfundojnë ciklin e studimeve tre vjeçare pajisjen me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj. Formatit i diplomës dhe i suplementit është i miratuar nga MAS. [Ref_139]
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në	Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se, studentëve të interesuar, me kërkesë të tyre, ju vihet në

dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	dispozicion një kopje e plotë e programit mësimor dhe syllabuset e lëndëve të zhvilluara, të firmosura nga titullari i Institucionit. Kjo kopje zyrtare i dorëzohet kërkuetit jo më vonë se 10 ditë nga kërkesa.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, IAL përpiqet të ruajë të dhënat e studentëve të diplomuar si dhe të ndjekë vijueshmërinë e punësimit të tyre pas diplomimit. Kohë pas kohe studentët kërkojnë dokumente specifike për të provuar statusin e tyre studentor për arsye të ndryshme. Sipas kërkesave të tyre, ekzistojnë lloje të ndryshme të dokumenteve të regjistruara, të lëshuara për t'u përdorur nga institucione të tjera. Sekretaria mësimore (SM) e FIE është struktura kryesore e cila administron, menaxhon dhe ruan dokumentacionin e studentëve për çdo program studimi në FIE. [Ref_008; 055]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>UPT në strukturën e vet organizative të tij ka miraturar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike. Kjo drejtori është përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, çështjet juridike si dhe sektorin e protokollit dhe arkivës institucionale. Referuar Organigramës së Universitetit Politeknik të Tiranës, sektori i Burimeve Njerëzore, si pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programet e studimit. [http://upt.al/burimet-njerezore]. Nga vizita në institucion u konfirmua se sektori burimeve njerëzore disponon një dosje të plotë, për secilin prej anëtarëve të personelit akademik të efektiv, e me kontrate, të përgjegjës të programit, të stafit ndihmës akademik. Gjithashtu lidhur me stafin e angazhuar në PS Bachelor në Inxhinieri Elektrike me profil Energjitik, KPS përditëson çdo vit të dhënat për personelin e angazhuar në këtë program. [Ref_001; 002; 008; 009; 017; 129] dhe Tabelat 1 & 2</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UPT ka hartuar dhe zbaton procedura të vecanta për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe Statutin e UPT. Për punësimin e personelit akademik me kohë të plote, bazuar në rregulloren e departamentit, fillimisht njësia bazë përcakton kriteret e pranimit të personelit akademik me kohë të plotë, kategorin e veprimtarisë që do të kryejë, ku përfshihen kriteret specifike për vendin e punës, si dhe kriteret e përgjithshme të përcaktuara në Statutin e UPT dhe ja përcjell drejtuesit të FIE. Drejtuesi i FIE, pasi bën verifikimin dhe konfirmimin e kriterëve, i dërgon për miratim tek Rektori. Për personelin akademik me kontratë, procedura ndiqet nga komision <i>ad hoc</i> i përbërë prej 3 vetash, ku bëjnë pjesë përgjegjësi i departamentit, përgjegjës të grupeve mësimore-shkencore të DSEF apo titullarë të lëndëve përkatëse. Në rast ankesash, komision është i detyruar të kthejë përgjigje të shkruar për çdo person të interesuar, brenda 5-ditëve kalendarike. Mbas përmbyllet procedura e mësipërme dhe mbas miratimit në dekanat, drejtuesi i njësisë i dërgon Rektorit listën me emrat fitues së bashku me kontratat përkatëse për firmë.</p> <p>[Ref_014; 025; 026]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato</p>	<p>Departamenti bën kërkesën për rekrutim të stafit dy here në vit, para fillimit të semestrit. U verifikuan dy praktika, në të cilat ishin specifikuar përveç kriterëve të përgjithshme në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, edhe kriteret specifike, të lidhura me fushën e ekspertizës që duhet të mbulojë personeli akademik. Nga verifikimi i CV të personelit akademik, rezultoi që në përgjithësi, personeli akademik me kohë të</p>


publike.	plotë e të pjesshme aktivizoheshin në mësimdhënje brenda fushës së tyre të ekspertizës. Kërkesa e departamentit përcillet nga dekanati në rektorat sipas procedurës së punësimit. Zyra e Burimeve njerëzore publikon vendet vakante në faqen e internetit si dhe në mjetet e tjera të informimit publik. [Ref_001; 008; 009; 025]			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	U shqyrtuan dy praktika rekrutimi të stafit akademik për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë. Në to ishin paraqitur kritere të përgjithshme, si niveli i kualifikimit i kërkuar, fusha e arsimimit, eksperiencia në punë, kualifikimi shkencor. Në kërkesën e departamentit shprehet edhe fusha për të cilën kërkohet rekrutimi i stafit, duke listuar lëndët në të cilat do të angazhohet në mësimdhënje. Në dy praktikatat e shqyrtuara, personeli akademik i rekrutuar kishte ekspertizën në përputhje me kërkesat specifike të shpallura. Komisioni i vlerësimit bën renditjen e kandidatëve që plotësojnë më mirë kërkesat për vëndin e punës dhe ja përcjell dekanit të fakultetit. [Ref 026].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Personeli akademik dhe ai administrativ ka në dispozicion ambiente plotësisht të rikonstruara e të dedikuara si dhe instrumenta të nevojshëm (kompjuter, lidhje internet, kancelari, etj) për kryerjen e aktiviteteve mësimore dhe administrative. Aktualisht ambientet janë të pajisura me sisteme ngrohje/ftohje, me izolim optimal termik dhe akustik, me infrastrukture të kënaqshme informatike, me ndriçim me plafone led etj. Si pjesë e riorganizimit të fundit, godina historike është pajisur me dalje dhe shkallë emergjence, me sistem monitorimi me kamera, me sistem për mbrojtjen kundër zjarrit, me tabela të emëruara për çdo klasë, sallë apo zyrë. Të gjitha ambientet i janë nënshtruar një riarredimi modern dhe uniform, sallat e leksioneve janë pajisur me tabela të bardha dhe lapsa lapustile. Ambjentet janë të hapura dhe të aksesueshme nga i gjithë personeli akademik.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtjeshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	UPT është angazhuar për sigurimin e kualifikimit të mëtjeshëm të personelit akademik. Në UPT janë strukturat për promovimin e titujve akademik. [Evidencë.2] UPT një nga drejtimet e tij kryesore strategjike ka zhvillimin e burimeve njerëzore, kapaciteteve infrastrukurore dhe financiare në shërbim të kërkimit shkencor dhe shërbimeve në të. [Ref_010; 028; 090; 092;0125].
Kriteri 3. Institucioni organizon	Siç parashikohet dhe në planet strategjike të UPT “Plani Strategjik

<p>programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>2019-2024”, FIE 2018-2023, të DA 2018 – 2023, që ofron këtë program studimi UPT synohet të jetë një institucion aktiv në implementimin e dijes, gjenerimin e ideve krijuese dhe nxitjen e shkencës në territorin e Shqipërisë nëpërmjet një mësimdhënie bashkëkohore sipas të gjitha standarteve ndërkombëtare, standarteve Europiane ESCO, deklaratës së Bolonjës dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Zhvillimi i metodave inovative në mësimdhënje, mbështetur kryesisht në teknologjinë e Informacionit janë pjesë e kërkimit shkencor të DA. Tema “Teknologjia dhe mësimdhënja” ka qënë fokusi në aktivitetet shkencore të departamentit.</p> <p>[Ref_ 010; 011; 027; 117]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Stafi akademik i DSEF i angazhuar në mësimdhënje është me nivel kualifikimi mbi nivelin e kualifikimit të Bachelorit. I gjithë personeli akademik efektiv dhe personeli akademik me kohë të pjesshme janë kryesisht me tituj akademik dhe gradë shkencore.</p> <p>Departamenti dëshmon se i ka dhe tejkalon burimet njerëzore të angazhuar për përmbushjen e objektivave të programit të studimit të ciklit të parë. [Ref_068].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UPT ka vënë në dispozicion të FIE godinën anësore, ku 3 kate të saj përdoren për zhvillimin e mësimi (klasa, laboratore), ambiente të përbashkëta (koridore, biblioteka, nyje sanitare), ambiente zyra për stafin etj. FIE ka në zotërim për zhvillimin e aktivitetit të saj mësimor dhe gjysmën e katit të parë në godinën e FTI. [Ref_132]</p> <p>Ambientet në përdorim nga FIE në këtë godinë janë si në vijim. Sallat e leksionesh/ seminaresh janë 20-të, me një sipërfaqe totale e tyre është 1172 m². Në ambient disponohet edhe një sallë për bibliotekë dhe aktivitete promovuese me sipërfaqe 60 m². Ambientet laboratorikë janë në harmoni me specifikat e moduleve lëndore. Fakulteti zotëron 9 laboratore për lëndët dhe një laborator informatike, në total 604 m². Në godinën shtesë të Korpusit Qendror, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike ka në përdorim sipërfaqen prej 300.6 m², që shfrytëzon në mënyrë të përbashkët me FIM dhe FTI . Sipërfaqja totale në përdorim nga FIE në të dy godinat, duke marrë parasysh sipërfaqet në përdorim dhe pjesën proporcionale të sipërfaqeve të përbashkëta është 7,078.25 m². Numri i studentëve aktivë për vitin akademik 2021 – 2022 është 1505. Raporti i sipërfaqes m²/student në ambientet e dy godinave ku</p>

	<p>zhvillon aktivitetin FIE (të përmendura më sipër) është 4.7 m²/student. Normativa 5 m²/student, e përcaktuar për IAL e profileve inxhinierike sipas legjislacionit në fuqi arrihet duke marrë në konsideratë pjesën proporcionale të ambienteve në përdorim në nivel institucioni siç janë Biblioteka Shkencore me sipërfaqe 1587 m² dhe IGJEO (Instituti i Gjeoshkencave) me sipërfaqe 2329 m². Proporcionalisht në funksion të FIE në këto dy godina janë 575.32 m² duke e bërë sipërfaqen totale që përdoret nga FIE në nivel institucioni të barabartë me 7653.78 m², që i korrespondon raporti 5.08 m²/student.</p> <p><i>Nga takimi në dekanat dhe departament mësuam se UPT kishte në zbatim nje plan-projekt për vendosjen e ashensorit në godinën historike me qëllim që të shfrytëzoheshin edhe katet e sipërme për personat me aftësi të kufizuara.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Të gjitha sallat janë të pajisura me orendi të përshtatshme për zhvillimin e mësimin dhe me mjetet e nevojshme teknologjike: kompjuter, videoprojektor etj, në funksion të mbarëvajtjes së mësimdhënies. E gjithë godina mbulohet nga rrjet interneti <i>wireless</i>, e disponueshme për të gjithë. Ajo që mungon në klasa është kompjuteri fiks tek tavolina e pedagogut. Lartësia e katit tavan/dysheme në secilën godinë është më e madhe se 3 m, ka izolim të mirë akustik, dhe me dritë, si dhe të pajisura me sisteme ngrohje-ftohje të centralizuara (të tipit chiller-AHU). Gjithashtu DSEF në FIE ka në dispozicion edhe 3 ambiente laboratorike që i shërbojnë procesit mësimor por edhe atij kërkimor-shkencor. Të gjithë këto laboratore rinovohen kohë pas kohe dhe janë të pajisura me pajisje elektronike dhe IT. [Ref_051; 065; 123]</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga takimet me stafin dhe vëzhgimi direkt konstatuam se UPT zotëron 88 laboratore specifike sipas moduleve dhe 12 laboratore për informatikën, të shpërndara nëpër godinat e tij [Ref_051]</p> <p>Nga këto laboratore, Fakulteti i Inxhinierise Elektrike zotëron 9 laboratore dhe 1 laborator informatike në dy godinat që zhvillon aktivitet [Ref_132]. DSEF ka tre laboratore që përmbajnë pajisjet e nevojshme teknike dhe informatike për të zhvilluar laboratorët dhe praktikën me studentët por mund të përdoret gjithashtu edhe për kërkime shkencore nga stafi i DSEF.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>UPT siguron gjithsej 12 laboratorë për lëndët e informatikës dhe teknologjisë së informacionit në tërësinë e ambienteve të tij.</p> <p>Lëndet e teknologjisë së informacionit, mbahen nga personeli nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, i cili ka në dispozicion 7 laboratorë modern dhe të pajisur me programe profesionale (gjuhët C, C++, Java, Python, sinjalet, rrjetat, sistemet elektronike etj.). [Ref_051; 132].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset</p>	<p>Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>

të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	UPT dhe FIE, është në bashkëpunim me institucione shtetërore dhe private, për ofrimin e shërbimeve gjatë praktikave mësimore. Bashkëpunimi me institucione dhe subjekte të tjera organizohet si në nivel institucioni, por edhe më specifikisht për këtë program studimi, në nivel njësie kryesore dhe asaj bazë. [Ref_019; 020] <i>Nga studimi i Akt-marveshjeve për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike, konstatohet që nuk përcaktohet qartë detyrimi për sigurimin shendetesor të studenteve për kohën e praktikës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Politeknik i Tiranës ka në dispozicion një bibliotekë shkencore qendrore për studentët e tij. Kjo bibliotekë është pjesë e korpusit qendror dhe ndodhet në sheshin Nënë Tereza. dhe ofron 65570 tituj dhe 75 vënde leximi. [Ref_050]</p> <p>Fakulteti i Inxhinierise Elektrike ka gjithashtu një qendër multimediale/ bibliotekë të vetën [http://www.fie.upt.al/biblioteka.php] të pajisur me afro 660 tituj libra të huaj dhe 226 tituj libra shqip, etj si dhe burime elektronike. Ajo ka 32 poste leximi/konsultimi. Të gjitha koleksionet janë të regjistruara në katalogun on-line, të përditësuara në linkun e mëposhtëm:</p> <p>(https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/search/simple?db=uptfie).</p> <p>Në veçanti, për objektivat formuese të programeve të studimit të ofruara në FIE, studentët bazohen kryesisht në Bibliotekën “Qendra Multimediale”, e cila ndodhet në ambientet e FIE dhe është e përbashkët me FTI, Bibliotekën Shkencore Qendrore të UPT, Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike/UPT. Biblioteka dhe ambientet e saj shërbejnë jo vetëm për konsultimin e librit por edhe si salla leximi apo studimi individual të studentëve. Në të ka kushte studimi optimale, ndriçim të përshtatshëm, izolim akustik të mirë dhe shërbim wireless.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të</p>	<p>Qendra multimediale, biblioteka në FIE, në funksion të aktiviteteve didaktike dhe shkencore të FIE, ka një literaturë të pasur dhe bashkëkohore për fushat me interes të kësaj njësie kryesore dhe programeve të studimit që ajo ofron. http://www.fie.upt.al/biblioteka.php</p> <p>Biblioteka Shkencore është e pajisur me një literaturë të pasur në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera. Ajo disponon libra, monografi,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 49


<p>gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>revista, akte kongresesh apo konferencash, manualesh e doracake etj. Biblioteka përmban tituj për fusha të ndryshme studimi dhe kjo i vjen në ndihmë studentëve të cilët kanë lëndë të ndërvarura nga fakultete të tjera (studenti i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike mund të konsultojë tekste mbi mekanikën dhe elektronikën, të cilët janë në dispozicion të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit), etj. https://bibliotekashkencore.edu.al/aksesimi-ne-bsh/</p> <p>Biblioteka Shkencore e UPT, gjatë periudhës 2017-2020, ka zgjeruar fondin e saj me 2105 njësi bibliotekare dhe 605 tituj të rinj.</p> <p>[Ref_049; 050]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka siguruar aksesin e studentëve në libraritë online. Këto librari aksesohen nën kujdesin e punonjësës së bibliotekës.[Ref_047]</p> <p>Libraritë <i>online</i> me drejtim kryesisht inxhinierik, të cilat e kanë të hapur aksesin janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sistemi COBISS (Co-operative Online Bibliographic System and Services). ➤ Libraria digjitale Jstor ➤ Baza e të dhënave UNPAYWALL <p>Biblioteka digjitale mundëson qasje në një bazë të dhënash me mbi 193 mijë libra akademikë, mbi 50 mijë revista shkencore, mbi 200 milion lajme shkencore si dhe 30 paketa për mësimin e gjuhëve të huaja.</p> <p>[https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries].</p> <p>Institucioni ka bërë të mundur që secili student, apo anëtar i stafit akademik, të ketë akses tek portali informatik U-Library. (https://ulibrary.rash.al/).</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Synohej që për vitin akademik në vazhdim, ambientet e bibliotekës të pajisen me kompjutera fizik për të lehtësuar konsultimin e titujve online. Gjithsesi, studentët mund të përdorin tabletin/laptopin personal apo pajisje tjera për ta bërë të mundur këtë gjë. Qendra multimediale që ndodhet në ambientet e FIE është e pajisur me kompjutera dhe softë kompjuterike të përshtatshme për shfrytëzimin e literaturës së huaj.</p> <p>Biblioteka e FIE duke patur kompjutera, fotokopje, printer, projektor, rrjet wireless, katalog elektronik etj. bën të mundur shfrytëzimin pakufizim nga ana e të gjithë studentëve.</p> <p>http://www.fie.upt.al/biblioteka.php</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Përditësimi i fondit të bibliotekës dhe shtimi i tij, ka qenë edhe një nga rekomandimet e akreditimit institucional të UPT-se. Çdo fillim viti akademik, DA bën kërkesat e tij për shtimin e librave në bibliotekë, si në tituj edhe në numër.</p> <p>[Ref_024; 029]</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit</p>	<p>Aktiviteti didaktik për këtë program studimi zhvillohet kryesisht gjatë orarit 08:00 – 16:00, orar që përkon edhe me atë të bibliotekave të institucionit. [Evidencë.99]</p>

të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka shkencore qendrore është në dispozicion të studentëve dhe të stafit akademik nëpërmjet infrastruktures së saj, ajo zbaton keto orare: nga e Hënë në të Premte: 08.00: 19.00, të Shtunën: 08.00: 14.00. [Evidencë.99; 100] Shfrytëzimi i ambienteve të tyre prej studentëve është në nivel të përballueshëm për kapacitetet egzistuese, madje një përlogaritje e punonjësve të bibliotekës konkludon në një shfrytëzim rreth 77% e sallave të leximit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	FIE ka në përdorim një sistem informatik për menaxhimin e të dhënave të lidhura ngushtësisht me aktivitetin e sekretarisë mësimore. [Ref_008; 055; 085] . Në vizitën e kryer në sekretari, u pa regjistri themeltar, regjistri i notave, disa procesverbale notash dhe procesverbali i ndërmjetëm. Regjistri themelatr ishte i plotësuar, të gjithë studentët ishin pajisur me numër matrikulimi. <i>Nuk u gjetën parregullsi</i> në hedhjen e rezultateve të studentëve nga procesverbalet në regjistrin e notave. Dosjet e studentëve dhe dosjet e transferimit të studentëve ishin të plota.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Informacionet që lidhen me aktivitetin e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe atij ndihmës akademik ruhen në Departament dhe në Drejtorine e Burimeve Njerëzore. Në takimin e bërë me Drejtorine e burimeve njerëzore, u verifikuan 2 dosje personale të personelit akademik efektiv. U synuan dosje që nuk ishin verifikuar në vlerësimet e mëparshme. Dosjet ishin të plota, me të gjithë informacionin dhe të dhënat personale të personelit: CV, ID, Diplomat e kualifikimit, librezat shëndetsore, Raporti mjeko-ligjor, librezat e punës, kontrata e angazhimit, aneks kontrate. Në përgjithësi rezultoi që personeli akademik efektiv dhe me kontratë është i angazhuar në mësimdhënie brenda fushës së tyre të kompetencës.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Studentët përmes Sekretarisë Online mund të aksesojnë në kohë reale të dhënat e tyre të përditësuara, rezultatet e arritura, lëndët të cilat duhet të frekuentojnë etj. [Ref_085] Informimi i personelit akademik realizohet nëpërmjet mbledhjeve, emaileve, website, platformës google classroom, office 365, të cilat në kushtet e zbatimit të rregullave të pandemisë së Covid 19 janë bërë domosdoshmeri. DA komunikimin nëpërmjet platformës google classroom kishte filluar ta aplikonte qe para 2-3 vitesh.

	Me fillimin e karantinës dhe aktualisht, personeli akademik i departamentit aplikoj me sukses platformën Teams “Microsoft Office 365”. [Ref_117]			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Stafi akademik, ai administrativ dhe studentët disponojnë <i>email</i> -et zyrtare të Institucionit, bashkë me të cilët ofrohet paketa Office 365. Aplikacionet e kësaj pakete mundësojnë ruajtjen dhe shpërndarjen e informacionit, si dhe komunikimin interaktiv në kohë reale ndërmjet përdoruesve. Me studentet është përdorur edhe platforma google classroom gjatë vitit akademik 2019-2020 për mësimdhënje, materiale studimore, etj. dhe moduli “Microsoft Teams”, gjeti një përdorim të gjerë në periudhën akademike të pandemisë Covid-19 gjatë vitit akademik 2020-2021. [Ref_083]			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Platformat e përdorura mundësojnë monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ si dhe bën të mundur që të gjenerohen raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për drejtuesit. Sistemi i menaxhimit siguron monitorimin e mësimdhënjes dhe të realizimit të aktiviteteve të tjera formuese edhe gjatë zhvillimit të mësimin në auditor apo gjatë procesit të kryerjes së praktikave dhe punimeve të detyrave të kursit e projekteve. Personeli akademik harton nje raport semestral në lidhje ecurinë dhe problematikat e dala gjatë zhvillimit të mësimin			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti Politeknik i Tiranës, ka në përdorim faqen web zyrtare, www.upt.al, në të cilën paraqiten të dhëna dhe informacione në nivel institucional për të gjitha fakultetet dhe institutet e saj, linku më tej të çon tek faqja e secilit fakultet. Informacionet në faqen e UPT ofrohen në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.[Ref_080; 120]. Fakulteti Inxhinjerisë Elektrike, mirëmban dhe përdor faqen web zyrtare www.fie.upt.al.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UPT harton çdo vit dhe miraton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Administrimin dhe koordinimin e veprimeve financiare është objekt i punës së strukturës administrative institucionale dhe në nivel njesie kryesore FIE [Ref_038; 039; 087]. Të dhënat e plota mbi mbështetjen financiare të programit të studentëve janë publike dhe gjenden në faqen zyrtare të UPT, në linkun: https://www.upt.al/rreth-nesh/programi-i-transparences

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>FIE përgatit plan financimi për të gjithë programet e studimit që mbështet. Ky plan financimi përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tyre. [Ref_039]</p> <p>Në fillim të çdo viti financiar personeli akademik i DSEF harton parashikime buxheti në lidhje me nevojat për investime laboratorike, bibliotekare, mbështetje për pjesëmarrje në konferenca, botime shkencore, libra të rinj etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Universiteti Politeknik i Tiranës, si një institucion publik, vepron në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi. UPT harton pasqyrat financiare konform akteve ligjore në fuqi dhe i shoqëron ato edhe me shpjegime të cilat janë objekt i analizës në senatin akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës. Organigrama e UPT e ka të specifikuar qartë pozicionin dhe varësinë e autoritetit të auditimit të brendshëm, i cili është nën varësinë e Bordit të Administrimit, BA, UPT kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij [http://www.upt.al/rrethnesh/programi-i-transparences] dhe në portalin [https://u-transparenca.al/].</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Universiteti Politeknik i Tiranës (Drejtoria Ekonomike) gëzon autonomi financiare. Burimet kryesore të financimit janë: të ardhurat nga buxheti i shtetit, pagesat e studentëve për shkollim, të ardhurat nga veprimtaria kërkimore dhe shërbimet e kryera për të tretë, donacione, të ardhura nga administrimi i mjediseve të tij dhe nga burime të tjera të ligjshme financimi. Buxheti i UPT hartohet në përputhje me përcaktimet e Statutit të tij, neni 29. (https://upt.al/dega-finance). Kërkesat hartohen fillimisht nga DSEF dhe më tej nga FIE. Projektbuxheti diskutohet në Dekanat, në Rektorat dhe në Senatin Akademik përpara miratimit nga Bordi i Administrimit</p> <p>[Ref_038; 039]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin</p>	<p>Universiteti ka burime financiare dhe kapacitete menaxhimi të qëndrueshme. Ai analizon treguesit e zbatimit të politikave financiare në mënyrë të vazhduar përmes Drejtorisë Ekonomike. Mesatarisht rreth 66% e të ardhurave (2017-2019) financohen nga shteti dhe rreth 34% e tyre gjenerohen prej UPT. Buxheti vjetor i UPT ka pësuar rritje të vazhdueshme me 8-10 %/vit gjatë viteve të fundit. Në të ardhurat që vetë UPT gjeneron, 53% burojnë nga tarifa e shkollimit. [Ref_040].</p>

e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Personeli akademik i DSEF jep një kontribut të rëndësishëm në shërbimet për të tretët duke përgatitur projekte elektrike dhe openca për pjesën e instalimeve elektrike të objekteve të ndryshme. [Ref_036; 040]			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar ne dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në UPT, GVJ konstato se Institucioni zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomim të tij, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të saksionuara edhe në rregulloret e brendshme të Institucionit. [Ref_001; 008; 010; 011; 012; 013; 014; 021; 044; 070]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në Planin strategjik të zhvillimit, Statut, Rregulloren e UP, Rregulloren e FIE shprehet qartë garantimi i barazisë dhe i të drejtave të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët e universitetit, duke synuar të tërhiqen kandidatët me rezultate më të larta. Kriteret e pranimit shpallen nga UPT dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe në portalin e Rrjetit Akademik Shqiptar. Regjistrimi i studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në Inxhinieri Elektrike kryhet pranë SM të FIE zbatuar renditjen sipas listave të publikuara të studentëve fitues, nëpërmjet një procesi transparent dhe jo diskriminues, duke mundësuar një konkurrencë të drejtë bazuar në vlerat individuale të gjithsecilit student. [Ref_062; 063; 064] [http://upt.al/bashkepunime/aktivitete/931-listat-e-renditura-te-kandidateve-ne-programet-e-studimit-2019-2020-raundi-1-sipas-fakulteteve-perkatese]
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, transferimi i studimeve nga një Institucion tjetër i arsimit të lartë, njohja dhe transferimi i krediteve të fituara në studimet e mëparshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi, janë të shprehura qartë në rregulloren e Institucionin dhe janë lehtësisht të aksesueshme nga studentët. Në takimin me studentët u theksua ndihma, mbështetja dhe sqarimet që marrin për çdo problem që hasin. [Ref_21; 60; 62; 67; 98]
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për	Bazuar ne dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në UPT, GVJ konstatoi se për pranimin e studentëve në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 55

<p>përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Elektrike, profili Energjitike” hartohen kriteret një vit përpara se ato të hyjnë në fuqi, Kriteret së bashku me kuotat e pranimit miratohen në nivel institucional dhe më pas raportohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin, konform akteve rregullatore në fuqi.</p> <p>Për përzgjedhjen e studentëve nga departamentet, miratohen në dekanat dhe më pas në SAUPT. [Ref_062; 063].</p> <p>Kriteret e pranimit shpallen nga UPT në website e tij dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe në portalin e Rrjetit Akademik Shqiptar, me qëllim që të aksesohen më shpejt nga maturantët. Gjithashtu këto kritere u bëhen të njohura maturantëve përgjatë aktiviteteve të ndryshme të informimit me ta (Panairt Work & Study).</p>			
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret dhe kuotat për pranimin në programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë në FIE miratohen në Senatit Akademik të UPT, përcillen në MASR dhe publikohen në portalin https://ualbania.al/</p> <p>Aplikimi kryhet nga kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, dhe janë të pajisur me:</p> <ol style="list-style-type: none"> dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor; nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, në IAL-të publike ose jopublike; plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave; plotësojnë kriteret e përcaktuara nga UPT për programin e studimit për të cilin aplikojnë. [Ref_008; 009; 037; 063] <p>Në propozimin e kuotave, respektohet një politikë e UPT, ku 10% e kuotave maksimale të alokuara për çdo program studimi u lihet në dispozicion kategorive të veçanta të studentëve, si kandidatë nga trojet shqipfolëse jashtë kufijve, shtetas të huaj, nga shtresat në nevojë, kandidatë me aftësi të veçantë, për transferim studimesh apo program të dytë studimi</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UPT përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe grupeve të informimit të maturantëve në fakultete, përpara fillimit të plotësimit të formularëve të aplikimit prej maturantëve organizon takime promovuese në ambjente e gjimnazeve të tyre, në ambjentet e UPT nëpërmjet Open Days 2022. UPT shpall edhe kalendarin përkatës për këto veprimtari. [Ref_060; 061; 130] Në website-in e UPT gjenden gjithashtu informacione dhe për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit. [Ref_043]</p> <p>Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike/ Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë, informon publikun edhe nëpërmjet faqes elektronike. Përcjelljen e këtij informacioni për publikun dhe të interesuarit, UPT e realizon edhe nëpërmjet aktiviteteve të tjera të realizuara në koordinim edhe me MAS. (http://www.fie.upt.al/).</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Institucioni që në regjistrim njih studentët me përmbajtjen e programit të studimit dhe rregulloren përkatëse, me vëmendje të veçantë në procedurat e përparimit të tyre akademik dhe kalimit nga një vit në tjetrin. [Ref_021]</p> <p>Këto kushte janë publike dhe në faqen zyrtare të UPT. (http://upt.al/kushtet-e-kalimit-ne-vitin-pasardhes).</p> <p>Platforma informatike BIT-ALBANIA që ofrohet nga RASH (https://upt.Bit-Albania.rash.al/login), dhe (https://bit-albania.com/upt6.php) e përdorur prej studentëve, u ofron atyre akses të plotë mbi procedurat e përparimit akademik në çdo kohë, si dhe marrjen e shërbimeve të tjera, sic është regjistrimi në një provim, etj. Per listën e notave, vërtetimet studenti mund të aplikojë në sekretarinë mësimore. (http://www.fie.upt.al/).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>UPT ofron mundësi për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme. (http://www.fie.upt.al/).</p> <p>Kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve jepen në mënyrë të hollësishme në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT [Ref_037]</p> <p>Këto kritere dhe procedura janë publike dhe të aksesueshme nga studentët e profilit Energjitikë gjithashtu në faqen web të UPT (http://upt.al/transferime) si dhe në faqen web të FIE (https://fie.edu.al/info/regjistrimettransferime)</p> <p>UPT njih studime të pjesëshme të realizuara jashtë UPT-së. Studentët në UPT, në kuadër të projekteve të ndryshme evropiane, mund të shkojnë dhe të realizojnë lëndë/module në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit, me të cilat UPT-ja ka marrëveshje të shkëmbimit të personelit akademik dhe të studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë javës së parë të vitit akademik, Institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave, stafi akademik, stafi administrativ janë në dispozicion të studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre, të tilla si kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambientet mësimore etj. [Ref_074; 085]</p> <p>Gjatë orëve të para të mësimin, gjithashtu, pedagogët njohin studentët me përmbajtjen e syllabusit të lëndës, në të cilën përfshihen edhe format e vlerësimit konkret për secilën lëndë [Nga, takimi me drejtuesit e fakultetit, departamentit dhe studentet].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon</p>	<p>Brenda një muaji nga data e fillimit të vitit akademik, Përgjegjësi i</p>

studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Departamentit u bën të njohur studentëve, të cilët diplomohen atë vit, programin e provimit të formimit, me anën e të cilave do të bëhet vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Diploma “Bachelor” mund të fitohet duke dhënë një provim të përgjithshëm formimi. [Ref_070]</p> <p>Para provimit të formimit cdo pedagog i programit Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë që zhvillon lëndë në ciklin bachelor zhvillon konsultime para hyrjes në provim të studenteve kandidat për diplomim.</p>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit si njësi strukturore mbështetëse e UPT-së, fillon informimin e maturantëve gjatë ditëve të informimit të organizuara nga MAS, dhe më pas në vazhdim për kandidatët e interesuar për programet e studimit që ofron me informacione më të detajuara mbi përmbajtjen e programeve të studimit dhe kriteret për pranimin në to. (http://upt.al/sherbimi-i-rrjetit).</p> <p>Këto janë takime të hapura, ku pjesëmarrja nuk është vetëm nga kandidatët për student, por edhe nga të afërm të interesuar. [Ref_021; 061; 120]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Gjatë javës së parë të vitit akademik dhe në vazhdim, studentët e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike drejtimi Energjitike”, organizon ditët orientuese, gjatë të cilave stafi akademik, stafi administrativ janë në dispozicion të studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre, të tilla si kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mësimore, kohëzgjatjen e programit të studimeve etj. [Ref_009; 021; 130; 131].
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>UPT dhe FIE ndjekin një politikë të informimit të vazhdueshëm të studentëve nëpërmjet të gjitha formave të mundshme si njoftimet e ndryshme në faqen zyrtare web (http://upt.al dhe http://fie.upt.al), njoftimet në ambientet e fakultetit, komunikimin direkt me pedagogoet, tutorët, përgjegjësit e departamenteve.</p> <p>UPT dhe FIE ka struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve, [Ref_018; 074; 080].</p> <p>Studentët informohen që në momentin e regjistrimit pranë “Sekretarisë mësimore” mbi organizimin, kohëzgjatjen dhe statusin e programit të studimit dhe deri në ditën e diplomimit.</p> <p>Për çdo informacion studentët mund të kontaktojnë drejtpërsëdrejti ose</p>

	përmes emailit institucional me: sekretarinë mësimore, pedagogun e lëndës, drejtuesin e DSEF, zv. Dekanin për anën mësimore, etj.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	<p>UPT, FIE, DSEF bën përpjekje të shumta për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme shtetërore dhe private për të krijuar mundësi punësimi për studentët e tij.</p> <p>Bashkëpunimet mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara. UPT, nga viti 2016 e në vazhdim, ka nënshkruar 13 marrëveshje me universitete vendase; 57 marrëveshje me universitete të huaja; 55 marrëveshje me kompani që operojnë në vendin tonë; 15 marrëveshje me institucione shtetërore. [Ref_019; 020].</p> <p>UPT është partner në projektin GRADUA me universitet të tjera shqiptare dhe të huaja, MAS dhe RASH për krijimin e një platforme, e cila shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe kompanitë private dhe shtetërore. Pedagogët në diskutime me studentët u japin informacion studentëve në lidhje me kompetencat që fitojnë studentët në këtë program studimi dhe mundësitë që kanë për punësim.</p>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve në ambientet e Universitetit, në sekretarinë <i>online</i> dhe në faqen e tij <i>web</i>, të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor. Çdo grupi studentësh i caktohet kujdestar një pedagog i DSEF që ofron programin e studimit. [Ref_104]. Studentët në javën e parë të regjistrimit të tyre pajisen me email zyrtar.</p>			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	<p>I gjithë informacioni i nevojshëm për studentin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitike, në lidhje me programin e studimit, orari, struktura mësimore, aktivitetet kurrikulare, etj është i aksesueshëm nga studenti edhe online përmes platformës së sekretarisë mësimore Bit-Albania e cila ofrohet me mbështetjen e Rrjetit Akademik Shqiptar. (https://bit-albania.com/upt6.php).</p> <p>Syllabuset u vihen në dispozicion studentëve me fillimin e semestrit.</p> <p>Në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia globale COVID-19, [Ref_124] në FIE u aplikua mësimi online nëpërmjet platformës Microsoft TEAMS.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	<p>Nga vizita në sekretarinë mësimore verifikuam qe mbahej regjistri i të diplomuarve, në të cilin regjistrohen të diplomuarit në vite sipas programeve të studimit. [Ref_054; 055]</p> <p>Gjithashtu sekretaria mban në formë të shkruar</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrin themeltar të studentëve • Regjistrin e arritjeve akademike të studentit • Regjistrin e lëshimit të diplomave <p>Ruajtja dhe përpunimi i këtyre të dhënave personale të studentëve kryhet bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale [http://www.pp.gov.al/web/ligj_mbrojtja_e_te_dhenave_personale_40.pdf].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Programi i studimeve për ciklin e parë Bachelor në Inxhinieri Elektrike profili energjitikë menaxhohet nga Sekretaria mësimore e FIE-së [Ref_055]. Institucioni mirëmban regjistrin themeltar, ku janë të regjistruar studentët në vite, si studente të regjistruar për here të parë, ashtu edhe ata të transferuar nga universitete të tjera.</p> <p>Në regjistër hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentëve, që nga pranimi deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Institucioni nepermjet sekretarise mësimore mban një regjistër me rezultatet akademike të studentit nga moment i regjistrimit deri në diplomim. Konstatuam qe regjistrat ishin të plotesuara në vazhdimësi. [Ref_014; 016].</p> <p>Gjithashtu përmes platformës Bit-Albania që ofrohet nga RASH, realizohen menaxhimi i karrierës së studentëve si: hyrjen (regjistrimin e tyre në programe studimi) dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave, etj.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me studentët. Sistemi i menaxhimit të tyre është i sigurtë dhe lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar. [Ref_085]</p> <p>Ky sistem mund të aksesohet nga studentët përmes Portalit të Sekretarisë Mësimore në [https://bit-albania.com/]. Ruajtja dhe përpunimi i këtyre të dhënave personale të studentëve kryhet bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Institucioni në mënyrë periodike harton raporte mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe shkallën e punësimit të studentëve. Theksojme se shumica e studentëve të këtij programi studimi vazhdojnë programet e ciklit të dytë në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë. Gjurmimi i punësimit të studentëve evidentohet për mes një regjistri përkatës që mbahet dhe përditësohet nga specialisti karrierës dhe alumnës [Ref_131].</p> <p>Në raportet e analizën vjetore të departamentit, ndërmjet të tjerave, analizohen të dhënat statistikore mbi cilësinë e studentëve gjatë viteve.</p> <p>Në rastet kur vihen re problematika lidhur me këto tregues, ndërmerren masa për përmirësimin e tyre. Këto të dhëna i përcillen ministrisë përgjegjëse për arsim me kërkesë të saj.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Përfaqësuesit e studentëve janë prezent në mbledhjet e departamentit dhe në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. Ata, gjithashtu, shprehin mendimet dhe kërkesat e tyre edhe përmes përfaqësuesve në Këshillin Studentor. Kryetari i Këshillit Studentor është pjesë e Senatit Akademik.</p> <p>[Ref_001; 006; 106; 107]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga takimi me studentet, doli qe organizimet studentore funksiononin dhe nëpërmjet tyre studentët përcillnin zërin dhe shqetësimet e tyre në organet drejtuese të universitetit, departament, fakultet, senatin akademik.</p> <p>[Ref_106; 107; 108]</p> <p>Aktualisht studentët kanë përfaqësuesit e tyre si anëtarë të Senatit Akademik të UPT, të cilët zgjidhen me votim të vetë studentëve përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senatin Akademik (4 studentë) - NJQSC në nivel institucioni (1 student) - NJBSC për program studimi (1 student) - Këshilli i etikës (ka 1 anëtar përfaqësues të studentëve) - Komisioni Institucional Zgjedhor – UPT (1 student) - Komisioni i zgjedhjeve në fakultet (1 student) - KPS e programit të studimit (1 student) - GVB e programit të studimit (1 student)
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Institucioni, gjatë hartimit të programeve të reja të studimit dhe rishikimit të programeve ekzistuese, kujdeset në plotësimin e standardeve të përcaktuara në udhëzimet përkatëse mbi ngarkesën akademike të studentëve në auditor. Ngarkesa e studentit jashtë auditorit përbën më shumë se 50% të orëve totale vjetore të parashikuara në planin mësimor.</p> <p>Institucioni kujdeset që procedurat e përparimit të studentëve përgjatë programit të studimit të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të realizueshme për ta. Institucioni bën njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme, konform me kuadrin ligjor në fuqi. Në rregulloren për regjistrimet dhe transferimet jepen kriteret dhe procedurat e njohjes të plotë apo të pjesshme të krediteve. Këto procedura zbatohen konkretisht. Grupi i vlerësimit shqyrtoi dosje të transferimeve dhe i gjeti ato konform me rregulloren. Në çdo rast, stafi i</p>

	zyrave përkatëse është në dispozicion dhe në mbështetje të studentëve për zgjidhjen e problematikave të ndryshme që mund të dalin gjatë studimeve të tyre. Studentët e programeve bachelor për të kaluar në vitin e dytë mjafton të kenë marrë 30 kredite ECTS. Ndërsa për të kaluar në vitin e tretë u mjaftojnë minimalisht 80 kredite ECTS, pamvarësisht ku I kanë marë ato. [Ref_018; 037; 067]			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Studentët në UPT janë pjesë përbërëse e KPS-ve të programit të studimit. Përfaqësuesi i studentëve në KPS bën të mundur transmetimin e të gjitha shqetësimit dhe problematikave të studentëve në lidhje me programin e studimit. KPS është përgjegjëse për mbështjen e procesit për sigurimin e cilësisë. [Ref_122]			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/ pedagogut përgjegjës.	Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korigjimit. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës brenda një afati prej 3 ditë pune nga shpallja e rezultetit. Kur ankesa është e drejtë, dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin student i është ankuar dhe vendos që student i të rivlerësohet ose të rijapë provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë, dokumentohet. [Ref_037]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Nga Organiograma e UPT dhe takimi me Drejtorinë e burimeve njerëzore mësuam se në UPT ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet e tij rregullatore si: 1. Drejtorinë e Kurrikulave në përbërje të së cilës janë dy sektorë në shërbim të studentëve: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sektori i Kurrikulave, ▪ Sektori i Procesit Mesimor. 2. Drejtorinë e Komunikimit dhe Koordinimit që ofron shërbimin e karrierës dhe ALUMNIT Procedurat e ndjekura prej këtyre njësive në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe



	aktet rregullatore të vetë universitetit. [Ref_002; 003]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis me informimin e maturanëve mbi programet e studimit të ofruara dhe vazhdon deri pas përfundimit të studimeve, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit.</p> <p>Institucioni përmes departamentit ofron udhëheqje dhe kujdestari (tutoriat) për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve. Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët.</p> <p>Nga takimi me studentët, doli që ndihma e pedagogeve nëpërmjet konsultimeve dhe materialeve ndihmëse ishte e madhe.[Ref_104; 110; 120]. Të gjitha strukturat e UPT që kanë lidhje direkt me informimin e studentëve, si zyrat e karrierës, sekretaritë mësimore dhe zyrat e financës vume re qe kishin të publikuara oraret e pritjes së studentëve me qëllim plotësimin e nevojave të studentëve.</p>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<p>Në UPT funksionon Zyra e Karrierës, në shërbim të këshillimit akademik të studentit, në kuadër të politikave për zgjerimin e hapësirave dhe mundësive ndërvepruese të studentëve, si pjesë përbërëse e mobilitetit rinor. UPT ofron këshillim dhe monitoron zhvillimin e karrierës akademike të studentëve [Ref_131]. UPT ofron shërbime me pikësnyim integrimin optimal të të diplomuarve të tij në tregun e punës dhe ndërmerr nisma, që synojnë krijimin e vendeve të reja për punë të kualifikuar. Ruan lidhje kulturore, profesionale dhe personale me të diplomuarit. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMN-it shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit. UPT mbështet aktivisht zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, me fokus në zhvillimin efikas të praktikave profesionale për ta. Ai nxit dhe mbështet krijimtarinë e studentëve, në partneritet të plotë me biznesin dhe mbi bazën e shanseve të barabarta dhe zgjerimin e internshipit. UPT është gjithmonë i hapur për aktivitete të përbashkëta me industrinë. Praktikant mësimorë zhvillohen në institucionet me të cilat “UPT” ka marrëveshje bashkëpunimi. [Ref_020]. UPT është gjithmonë e hapur për aktivitete të përbashkëta me 55 Institucionet e industrisë vendase publike dhe private që ka marrëveshje bashkëpunimi..</p>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p>Nga studimi i DVV, takimi me stafet akademike, administrative dhe studentët evidentuam se :</p> <p>Zyra e Karrierës përmes njoftimeve në web dhe përmes materialeve informuese të afishuara në mjediset e universitetit njofton vazhdimisht studentët për mundësi për aplikime në lidhje me punësimin e tyre (http://upt.al/bashkepunime/aktivitete).</p> <p>Të gjitha strukturat e UPT, personeli akademik, ndihmës mësimorë shkencorë dhe personeli administrativ angazhohen për zbatimin e politikës për integrimin në punësim të studentëve. UPT disponon të</p>

	dhëna, për punësimin e studentëve të vet, me të cilët mban kontakte të vazhdueshme. Për ngritjen e rrjetit Alumni ka filluar puna përmes një pyetësori për të identifikuar studentët e diplomuar në UPT dhe për të ndjekur zhvillimin e karrierës së tyre. Deri më sot është krijuar një databazë me mbi 200 të diplomuar që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e rrjetit Alumni në UPT [Ref_071]. Në këtë kuadër edhe në FIE është ngritur shoqata Alumni/ae e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike Energjitike, AIM (https://FIE.edu.al/FIE/alumniae-inxhinieria-Elektrike Energjitike-aim).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UPT ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet e tij rregullatore.</p> <p>Nga DVV dhe takimi ne Institucion mesuam se në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies ishin ngritur Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) dhe Drejtoria e Kurrikulave (DK) [Ref_002].</p> <p>DSBC dhe DK, nëpërmjet fakulteteve, koordinojnë punën me departamentet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Pranë çdo njësie kryesore, ishte ngritur dhe funksiononte një njësi NJSBC. [Ref_008]. Studentët e këtij programi studimi, dhe në përgjithësi të gjithë studentët e regjistruar në programe e studimit të ofruara nga FIE, informohen vazhdimisht me anë të postës elektronike, nga përgjegjësi i zyrës së Sigurimit të Cilësisë, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t në FIE.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UPT është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative [Ref_001 , Neni 78]. Për këtë, funksionon Rrjeti i Cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UPT. Rrjeti i Cilësisë përbëhet nga Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC), e ngritur në rektoratin e UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të UPT [Ref_002]. NJQSC harton standardet institucionale të cilësisë bazuar në Kodin e proceseve vlerësuese [Ref_001]. Këto standarde miratohen nga SAUPT. UPT zhvillon dhe zbaton mekanizma për promovimin dhe zotërimin e një kulture të cilësisë në të gjitha njësitë dhe të gjitha nivelet, zhvillimin e procedurave për monitorimin dhe rishikimin e cilësisë akademike, rritjen e cilësisë në qeverisje dhe menaxhimin e institucionit, me synim rritjen e cilësisë në të gjitha programet e studimit që ofron [Ref_010, Kreu IV.1]. Një instrument shumë i rëndësishëm në procesin e sigurimit të cilësisë është dhe akreditimi institucional dhe akreditimi i programeve të studimit. Në këto procese janë dy etapa të rëndësishme: vetëvlerësimi (ose vlerësimi brendshëm) dhe vlerësimi i jashtëm. Në vlerësimin e brendshëm krahas stafit akademik përfshihen dhe studentët si pjesë e rëndësishme e këtyre proceseve [Ref_137]. Gjithashtu në vlerësimin e jashtëm një rol të rëndësishëm ka bashkëpunimi me ASCAL dhe specialistët e tij për kryerjen me sukses të akreditimit të PS. Në funksion të Sigurimit të</p>

	<p>brendshëm të cilësisë Departamentet e FIE që mbulojnë programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike – Profili Energjitikë” konkretisht: Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë, Departamenti i Automatikës dhe Departamenti i Elektroteknikës [Ref_056] operojnë në koherencë të plotë me procedurat e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike FIE, i cili nga ana e tij respekton procedurat që janë përcaktuar nga strukturat e nevojshme në nivel institucioni, në të cilat garantohet dhe përfshirja e stafit dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UPT-ja ka kaluar akreditimin e dytë institucional duke <i>përbushur plotësisht</i> Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe për rrjedhojë ka fituar akreditim gjashtëvjeçar.</p> <p>[https://www.ascal.al/media/documents/rvj/IAL_48_114.pdf]</p> <p>Gjithashtu, UPT përvec akreditimit institucional në muajt Prill-Maj 2022 i është nënshtruar dhe vlerësimit nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve, rezultatet e të cilit priten të dalin së shpejti dhe të bëhen publike prej ASCAL.</p> <p>(https://www.ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve/metodologjia-dhe-instrumentat/sks-2022).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Universiteti Politeknik i Tiranës duke patur qëllim sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike.</p> <p>Në Kreun IX të Statutit të UPT-së [Ref_001] përshkruhen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Në mënyrë periodike nëpërmjet NJSBC-së, në fund të çdo semestri përpara sezonit të provimeve, organizohet pyetëtori studentor [Ref_135] për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Në mënyrë periodike NJSBC-ja raporton dhe informon drejtuesit e njëjësive bazë dhe kryesore dhe përmes tyre të gjithë stafin e UPT-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së institucionit, njëjësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Gjithashtu, në përfundim të vitit akademik njëjësia bazë harton një raport sraport vjetor, në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat e marra për përmirësimin në të ardhmen. [Ref_137].</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Njësia përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Sistemeve Elektrike të fuqisë ku janë ngritur dhe funksionojnë këshillat e programeve të studimit ku në përbërjen e tyre janë të përfshirë personel akademik me përvojë së paku 10 vjeçare në mësimdhënie pranë kësaj njësie. [Ref_073] Këto grupe <i>ad-hoc</i> , të cilat përbëhen nga staf akademik i brendshëm i njësisë bazë, konkretisht 2 apo 3 pedagogë me tituj e me grada, të cilët punojnë për rishikimin e kurrikulave dhe syllabuseve, në bashkëpunim me lektorët e lëndëve, hartimin e raportit të vetëvlerësimit për programin e studimit, si dhe janë pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm në rastet e akreditimit të programeve të studimit. [Ref_059; 078; 119]
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Çdo fillim viti akademik bëhet përditësimi i syllabuseve nga titullarët e lëndës në bashkëpunim me lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorët të cilat nuk e kalojnë masën e ndryshimit 20% të tij të shprehur në kredite.[Ref_037; 059]. Ky aktivitet zhvillohet nën kujdesin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, dhe me Grupin e Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti. U konstatua se në përbërje të grupit kishte personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë. Gjithashtu në grupin e ekspertëve kishte përfaqësues nga bota e biznesit. I gjithë dokumentacioni i plotë i programit të studimit për vitin pasardhës, mbasi është miratuar në njësinë bazë, përcillet në njësinë kryesore e cila i përcjell ato pranë Drejtorisë së Kurrikulave pranë Rektoratit.
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Institucioni i është nënshtruar riakreditimit të jashtëm institucional nga BA me Vendimin Nr. 01, datë 07.01.2022, e ka përfutur atë për periudhën 07/01/2022 deri në 06/01/2028 dhe njëkohësisht ka filluar procedurat për akreditimin e programeve të studimit. Drejtorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me dy sektorët përbërës, “Sektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” dhe “Sektori i Statistikës dhe Informacionit” përpunojnë të dhënat e mbledhura nga pyetësorët studentorë, por gjithashtu mbledhin dhe përpunojnë të dhëna nga të gjitha njësitë kryesore dhe bazë përbërëse të UPT. [Ref_013; 014]
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet e vlerësimeve nga pyetësorët e studentëve , të realizuara nga sektori i Statistikës dhe Informacionit konform rregullores së brendshme, dokumentohen në formë shkresore, përpunohen dhe i dërgohen të gjitha instancave përkatëse. Kështu, pas realizimit të focus grupeve, informacioni i dërgohet Rektoratit dhe çdo njësi bazë

	<p>me qëllim marrjen e masave për përmirësime të mundshme në të ardhmen. [Ref_059; 072]</p> <p>Gjithashtu, pas mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, informacioni me problematikat përkatëse dërgohet në fakultet, department, të cilet i diskutojnë në mbledhje të posaçshme dhe ia komunikojnë në mënyrë konfidenciale personelit akademik. Për më tepër, të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e studentëve diskutohen edhe në mbledhje të Senatit Akademik. Këto raporte bëhen publike në faqen ueb të UPT. [https://upt.al/cilesia-ne-upt]</p>			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	<p>Në raportin e vlerësimit të hartuar nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT, përfshihen të dhëna përshtetëse dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, që mbulon departamenti, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen. [Evidencë.14]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	<p>Struktura përgjegjëse në Universitetin Politeknik të Tiranës [Ref_002], e cila monitoron, shqyrton, mbikqyr, rishikon programet e studimit të ciklit të parë, është Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për ciklin e I dhe të II përmes Sektorit të Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve.</p> <p>Komisionet e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësitë Bazë/ Departamentet (KSCBF) janë ende struktura jo të plota dhe të konsoliduara në praktika. Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike (FIE) i cili mbështet programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitike ka në strukturën e vetë specialist për sigurimin e cilësisë në FIE [Ref_003]</p> <p>Nisur nga RVB dhe takimet në Institucion, GVJ konstatoi se Institucioni përdor si metodë të matjes së cilësisë së veprimtarive akademike, vetëm pyetësorët drejtuar studentëve.</p>
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës	<p>Grupi i vlerësimit të brendshëm i ngritur nga Dekanati, gëzon autonomi funksionale dhe ka qasje në të gjitha të dhënat e institucionit. Përveç vlerësimeve në rang Institucioni, [Ref_135] angazhohet në vlerësimin e programeve të studimit dhe ofertës akademike me metoda dhe instrumenta specifike të fushës.</p> <p>Në mënyrë të vazhduar, edhe si pjesë studimesh kërkimore –</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 68

<p>akademike të programit të studimit.</p>	<p>shkencore të stafit akademik, departamenti i drejtohet studentëve për të marrë <i>feedback</i> për problematika të ndryshme, të cilat prekin drejtëpërsëdrejti programet e studimit të ofruara.</p> <p>Në hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm, GVB, mbështetet në analizën statistikore të të dhënave, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetësorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin jo akademik, studentët dhe grupet e interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionin. Rezultatet e vlerësimeve bëhen publike si brenda njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, ashtu edhe brënda institucionit në Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në funksion të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike, Profili - Energjitikë”, përdoren disa metoda të drejtëpërdrejta vlerësimi:</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe kurrikulës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në nivel njësie bazë: <p>Drejtuesi i njësisë bazë informohet në mënyrë të vazhduar nga i gjithë stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi rreth procesit të mësimdhënies, dhe ushtron kontroll rreth zbatimit të tij. Rezultatet pasqyrohen në analizat periodike të njësisë bazë.</p> <p>Drejtuesi i njësisë bazë përgjigjet në Dekanatin e FIE për mbarëvajtjen e procesit mësimor për programet e studimit që mbulon si njësi bazë por edhe për lëndë të veçanta që mbuloohen në njësi të tjera bazë në UPT:</p> - Në nivel njësie kryesore: <p>Dekani me anë të Zv. Dekanit për anën mësimore dhe sekretarisë mësimore, mbikëqyr zhvillimin e aktiviteteve didaktike konform strukturës mësimore dhe orarit mësimor të miratuar , [http://www.fie.upt.al/Orari_i_mesimeve.php].</p> <p>Ndjek dhe monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës së programit të studimit në përputhje me planin mësimor. Përpunon të dhënat e nxjerra nga analizat mësimore të njësie bazë përgjegjëse dhe i raporton ato në Rektorat.</p> <p>Metodat dhe vlerësimet e drejtëpërdrejta, nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe rishikimit të kurrikulave, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës, apo edhe kërkesave të personelit akademik, e studentëve kur vlerësoheshin si të domosdoshme, shërbenin për analiza konkrete dhe ndërtimin e metodologjisë së punës për të ardhmen. [Ref_008; 013]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista</p>	<p>Si njësi bazë, ashtu edhe ajo kryesore, përveçse të bazohet në raportet e hartuar nga stafi akademik për sa i përket mësimdhënies [Ref_071], ndjek edhe metodika alternative dhe plotësuese si pyetësorët studentorë dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të aktiviteteve didaktike me kontrolle rastësore dhe periodike në auditor.</p> <p>Pjesë e metodikës është edhe gjurmimi i ALUMNI i realizuar edhe në</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 69

të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	projektin GRADUA ku UPT është anëtar. Nga takimi me studentet mesuam se ne pyetesoret ruhej anonimiteti. Pyetesoret e realizuara me studentët aktualë janë periodike, dy herë në vit. Ndërkohë, në nivel universiteti, fakulteti u rekomandua që ne të ardhmen të realizohen pyetesoret me personelin akademik, për të marrë përshtypjet e tyre në lidhje me çfarë i ofron Institucioni dhe sa të kënaqur janë ata etj. UPT nëpërmjet pjesëmarrjes në projektin GRADUA, ka krijuar një database të rëndësishme të studentëve dhe kompanive. Studentët regjistrohen dhe publikojnë CV në këtë database, duke rritur kështu mundësinë e punësimit. Kompanitë e ndryshme në bazë të kriterëve të tyre përzgjedhin drejtpërdrejtë studentët e regjistruar në sistemin GRADUA.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në kuadër të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë, institucioni nxit dhe garanton plotësimin e standardeve të cilësisë dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të tij në politikat dhe procedurat që lidhen me to. Në grupin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të programit të ketij programi studimi ka dhe një përfaqësues i studentëve. [Ref_137].
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ, nisur nga DVV, verën se vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë në nivel institucional por edhe njësie bazë dhe kryesore, ka shërbyer për të përcaktuar objektivat të qarta për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara në tërësi e pasqyruar kjo edhe në hartimin e objektivave të zhvillimit strategjik institucional dhe të njësisë kryesore. [Ref_008; 009]. Në rritjen e përfshirjes së studentëve në organet kolegjiale vendim marrëse, edhe organeve rregullatore, në UPT është e miratuar një rregullore specifike për përzgjedhjen dhe organizimin në sigurimin e brendshëm të cilësisë nga radhët e stafit akademik e studenteve.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin	Në procedurat e vlerësimit të cilësisë marrin pjesë të gjithë aktorët, të cilët kanë një ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin e programit të studimit. Njësia bazë, personeli akademik dhe administrativ, si dhe studentët, luajnë një rol të rëndësishëm bashkëpunues me strukturat e sigurimit të cilësisë në nivel

e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	institucional. Në rregulloren e NJSBC janë përcaktuar raportimet për sigurimin e cilësisë që bëhen nga personeli akademik, përgjegjësit e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, grupet e cilësisë së njësisë bazë, përfshirja e gjykimit të studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënjes, etj. [Ref_137]			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Institucioni respekton të drejtat themelore të çdo pale të përfshirë në jetën universitare, si dhe respekton Kodin e Etikës të UPT.[Ref_006] Ngritja e grupit të vlerësimit të brendshëm bëhet mbi bazën e shmangies të konfliktit të interesit me postin që ata mbajnë. <i>Nga takimet në institucion vërejtëm që në DSEF, FIE nuk ka asnjë praktikë ankimi nga ana e studentëve apo stafit akademik dhe administrativ për diskriminim dhe pabarazi.</i> Kontrolli i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies ka garantuar bazarinë e plotë midis anëtareve të stafit akademik si dhe midis studentëve.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në kuadër të vlerësimeve periodike të programeve të studimit, një vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet sugjerimeve dhe rekomandimeve të dhena nga ekspertët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, në fazën e rishikimit të programeve të studimit, brenda masës së lejuar deri në 20%. [Ref_122] Ekspertiza e tyre ka qenë e vlefshme sidomos në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, në aspektet e lidhjes së teorisë me praktikën. Mendimi i ekspertëve është tërhequr jo vetëm nëpërmjet angazhimit të tyre në mësimdhënie, por edhe në takime të ndryshme, në leksione të hapura, work-shope etj. [www.polimi.it, www.polito.it]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat dhe strategjia mbi të cilën funksionon sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT, janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional. Objektivat dhe mekanizmat të cilat janë publike për të gjithë të interesuarit dhe të afishuara edhe në faqen e internetit të UPT në zërin e “Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. UPT dërgon pranë MAS raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore – shkencore të Institucionit, si dhe e bën publike për të gjithë të interesuarit në faqen web [www.upt.al].
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën	Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore – shkencore të institucionit përfshin të dhëna të përmbledhura statistikore për secilin program studimi, duke ruajtur dhe respektuar lirinë akademike, kodin e etikës dhe sigurinë e të dhënave personale. Raporte të cilat ruhen në

akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	arkivën institucionale konform akteve rregullatore në fuqi. [Ref_135]			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti vjetor i FIE dhe DSEF përfshin të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimit për vitin e ardhshëm akademik. Në këtë program studimi nuk ka pasur ndryshim të kurrikulës në tre vitet e fundit akademike. Këto raporte publikohen online në web-in e UPT. [https://upt.al/cilesia-ne-upt].			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	I gjithë procesi i monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike Profili Energjitikë. [Ref_002; 013; 014] <i>Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se ka një ndryshim cilësor në këtë drejtim, krahasuar me vlerësimin e parë Institucional.</i> Drejtimesit e njësisë bazë, njësisë kryesore dhe të institucionit kanë bërë përpjekje serioze për përmirësimin e cilësisë së këtij program studimi. Nga analiza e bërë na rezulton se një pjesë e masave të marra kanë qenë efektive dhe kanë dhënë rezultat. [Ref_073; 095; 096] <i>Rekomandohet që në raportimet vjetore, departamenti të bëjë një vlerësim të efektivitetit të masave të marra për përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit mbi bazën e rekomandimeve e sugjerimeve që bëhen në këtë RVJ.</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në nivel institucional, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon në mënyrë periodike seanca informuese/trajnuese me stafin akademik dhe atë administrativ për rritjen e vetëdijes institucionale rreth përmirësimin afatgjatë të cilësisë. DSEF, pedagogët koordinatorë për çdo program studimi. në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese, si dhe pas çdo procesi të vlerësimit të jashtëm, informonin studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. [Ref_061; 076]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike, Profili “Energjitikë” i Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i Tiranës”, Tiranë.

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Programi i studimit mbështetet në parimin e ndër-disiplinaritetit, për t’iu përshtatur nevojave të një game të gjerë aplikimesh dhe nevojash në fushën e energjistikës, duke krijuar mundësi për të realizuar studime origjinale, që kanë ndikime në sektorë dhe fusha thelbësore të teknologjisë dhe të rëndësishme për vendin tonë.
2. Programi i studimit që vlerësohet, Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, Profili “Energjitikë” është inovativ dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës.
3. Cilësia e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie dhe drejtim shkencor të punimeve doktorale, i cili ka tituj akademike, eksperiencë në mësimdhënie dhe përvojë të gjatë akademike e profesionale, në projekte dhe kërkim shkencor per fushën e energjistikës.
4. Programi i studimit mbështetet nga biblioteka me karakter tekniko-shkencor dhe Qendra multimediale, e cila ka vlera të veçanta studimore mbi literaturë specifike në drejtim të fushës së Inxhinierisë Elektrike me Profil Energjitikë.
5. Institucioni zhvillon mekanizma specifik duke krijuar partnerë me mision mbështetjen dhe kualifikimin profesional të personelit akademik, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me vizion, me kompani lider në industri e me institucione me reputacion brenda dhe jashtë vendit.
6. Staf i DSEF nën strukturat e UPT-së është integruar për të ofruar shërbime për të tretë duke mbajtur marrëdhënie aktive me tregun e punës dhe industrinë, gjeneron të ardhura të konsiderueshme për institucionin në studimet e ndërmarrja për transferimin e teknologjisë, me rezultatet e kërkimit dhe ofrimin ekspertizës së nevojshme.
7. Niveli i lartë i notës mesatare të studentëve që zgjedhin të ndjekin studimet pranë DSEF në FIE, garanton implementimin me sukses të programeve të studimit në të gjitha ciklet e studimit.
8. Përfshirja e studentëve në vendim-marrje nxit dhe mbështet forcimin e zërit të studentëve dhe rrit rolin aktiv të tyre procesin e vendimmarrjes në UPT.
9. Mjediset e përshtateshme dhe infrastruktura didaktike moderne në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mesimor.
10. Mbulimi i lëndëve të programit të studimit ku bëjnë pjesë ekspertët më të mirë është në përputhje me fushën e ekspertizës të personelit akademik, realizon mobilitetet drejt universiteteve me të cilat bashkëpunon.
11. Sistemi elektronik-informatik funksional në menaxhimin e informacionit në funksion të administrimit të brendshëm institucional dhe veçanërisht të procesit mesimor.

Pika të dobta:

1. Mungesa e botimeve të reja për tekste në gjuhën shqipe për një pjesë të lëndëve profesionale të programit të studimit, mbulohej me leksione të shkruara bazuar në literaturë bashkëkohore. **(Standardi II.4, kriteri 6)**
2. Nga studimi i Syllabuseve për çdo lëndë, vërehet se ka dispropocione të theksuara në “peshën” e pikëzimit në përcaktimin e notës përfundimtare. Provimi i ndërmjetëm zhvillohet nga pedagogët jashtë mbikqyrjes së departmentit. **(Standardi III.5, kriteri 2)**

Rekomandime:


1. Të nxitet dhe stimulohet angazhimi i pedagoqeve në shkrimin e botimit të teksteve të reja në gjuhën shqipe për lëndët profesionale të programit të studimit që mbulohej me leksione të shkruara.
2. GVJ rekomandon rishikimin e vazhdueshëm të kurrikulës dhe programeve mësimore në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Në syllabuse të jetë i qartë dhe i standardizuar vlerësimi i studentit me pikëzim në të gjithë rubrikat dhe azhurnimi periodik i rezultateve në sekretarinë mësimore.
3. Të rishikohet përmbajtja lëndore dhe pesha e tyre në ECTS në plan programin mësimor, në mënyrë që edhe tipi i veprimtarisë lëndë plotësuese (D) të jetë brenda kritereve të përcaktuara.
4. Në kontratat dhe aktmarrveshjet për praktikat mësimore të përcaktohet qartë detyrimet për sigurimin shëndetësor të studenteve gjatë praktikës mësimore.
5. GVJ rekomandon Departamentin të parashikojë në rregullore dhe të nxisë e mbështesë studentët e vitit të tretë me rezultate të larta (me mesatare mbi 9.0), për mbylljen e studimeve me temë diplome, duke mbështetur kështu edhe përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor.
6. Të gjenden mekanizma bashkëpunimi për nxitjen dhe promovimin e nismave të studentëve për krijimin e modeleve të reja të biznesit dhe start-up-eve, me synim mbështetjen e inovacionit dhe zhvillimit teknologjik, pavarësisht nismave individuale të pedagoqeve.



Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program "Electrical Engineering, Energy Profile." of the Institution of Higher Education "Polytechnic University of Tirana", Tirana.

Strengths and Affirmations:

1. The study program is based on the principle of inter- disciplinarily, to adapt to the needs of a wide range of applications and needs in the field of energy, creating opportunities to carry out original studies, which have impacts on essential sectors and fields of technology and important for our country.
2. The evaluated study program, Bachelor in "Electrical Engineering, Profile Energy" is innovative and in line with the needs of the labor market.
3. The quality of academic staff engaged in teaching and scientific direction of doctoral theses, who have academic titles, experience in teaching and long academic and professional experience, in projects and scientific research in the field of energy.
4. The study program is supported by a technical-scientific library and a multimedia center, which has special study values on literature specifically in the field of Electrical Engineering with an Energy Profile.
5. The institution develops specific mechanisms by creating partners with the mission of support and professional qualification of academic personnel, has signed cooperation agreements with vision, with leading companies in the industry and with reputable institutions inside and outside the country.
6. The staff of DSEF under the structures of UPT is integrated to provide services to the third by maintaining active relations with the labor market and industry, generates significant income for the institution in the studies undertaken for the transfer of technology, with the results of research and providing the necessary expertise.
7. The high grade point average of students who choose to study at DSEF in FIE guarantees the successful implementation of study programs in all study cycles.
8. The involvement of students in decision-making encourages and supports the strengthening of the students' voice and increases their active role in the decision-making process at UPT.
9. Appropriate environments and modern didactic infrastructure available to the study program provide the necessary contemporary spaces and conditions for the educational process.
10. The coverage of the subjects of the study program where the best experts are part is in accordance with the field of expertise of the academic staff, it realizes mobility towards the universities with which it cooperates.
11. Functional electronic-informatics system in the management of information in function of internal institutional administration and especially of the teaching process.




Weak points:

1. The lack of new publications for texts in the Albanian language for a part of the professional subjects of the study program was covered with written lectures based on contemporary literature. **(Standard II.4, criterion 6)**
2. From the study of the Syllabus for each subject, it is observed that there are pronounced disproportions in the "weight" of the scoring in determining the final grade. The intermediate exam is conducted by lecturers outside the supervision of the department. **(Standard III.5, criterion 2)**

Recommendations:

1. To encourage and stimulate the engagement of lecturers in writing and publishing new texts in the Albanian language for the professional subjects of the study program that were covered by written lectures.
2. GVJ recommends the continuous revision of the curriculum and teaching programs in accordance with the legal and by-law provisions in force. In the syllabus, the evaluation of the student should be clear and standardized with points in all sections and the periodic updating of the results in the teaching secretariat.
3. To review the subject content and their weight in ECTS in the curriculum plan, so that the type of supplementary subject activity (D) is within the defined criteria.
4. In the contracts and agreements for the teaching practices, the obligations for the health insurance of the students during the teaching practice should be clearly defined.
5. GVJ recommends the Department to regularly anticipate and encourage and support third-year students with high results (with an average above 9.0), for the closing of diploma-themed studies, thus supporting the involvement of students in scientific research.
6. To find cooperation mechanisms for encouraging and promoting student initiatives for the creation of new business models and start-ups, with the aim of supporting innovation and technological development, regardless of the individual initiatives of pedagogues.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X